



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE
SUNDIMIN E LIGJIT

Dokument Udhëzues për rishikimin e Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë në lidhje me paraburgimin

Përgatitur nga Ekspertët e Këshillit të Evropës:

Theo BYL, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Antwerp, Belgjikë

Nicola LETTIERI, Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm në Gjykatën e Lartë të
Kasacionit, Itali

Filipe César MARQUES, Gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Audituesve, Lisbonë,
Portugali

Përjashtim nga përgjegjësia:

Ky Dokument Udhëzues është përgatitur nga ekspertë ndërkombëtarë të angazhuar nga Departamenti i Bashkëpunimit për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësinë¹ dhe Departamentit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, të Këshillit të Evropës.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

¹ Në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës *“Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri”*, të financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF) i cili bashkon tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës: Finlandë, Gjermani, Irlandë, Luksemburg, Holandë, Norvegji, Zvicër, Mbretëri e Bashkuar.

Për më tepër informacion ju lutemi të kontaktoni:

Departamentin e Bashkëpunimit për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtësinë
Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit
Këshilli i Evropës
67075 Strasbourg CEDEX France
e-mail: dgi-coordination@coe.int
<https://www.coe.int/en/web/implementation>

Departamentin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit
Departamenti kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit
Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit
Këshilli i Evropës
67075 Strasbourg CEDEX France
e-mail: contact.econcrime@coe.int
www.coe.int/econcrime

TABELA E PËRMBAJTJES

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
2	HYRJE.....	11
	2.1 Qëllimi, metodologjia dhe objekti.....	11
	2.2 Përmbledhje e instrumenteve ligjore ndërkombëtare.....	11
3	PARABURGIMI: BAZAT LIGJORE DHE GARANCITË	15
	3.1 Shkaqet dhe vendimi për paraburgim	15
	3.2 Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore	18
	3.3 Kohëzgjatja dhe shqyrtimi periodik i paraburgimit	21
	3.4 E drejta për avokat dhe garanci të tjera procedurale	26
	3.5 Alternativat ndaj paraburgimit	29
	3.6 Konsideratë Specifike për Personat në Situatë Vulnerabël	33
	3.7 Ankimimi dhe mjetet juridike	34
4	ÇËSHTJE NDËRSEKTORIALE.....	36
	4.1 Mbledhja e të dhënave.....	36
	4.2 Nevoja për një ndryshim në kulturën gjyqësore - një qasje globale	38
5	KONKLUZIONE	44

SHKURTIME

KP	Kodi Penal
KDTBE	Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian
KPP	Kodi i Procedurës Penale
Konventa	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
Gjykata	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
GJKKO	Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
DU	Dokument Udhëzues
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PZHKB	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)
ZKBDK	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Dokument Udhëzues (DU) u hartua me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, me qëllim informimin e procesit të hartimit legjislativ për të ndryshuar Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP), me një fokus të veçantë në dispozitat që lidhen me paraburgimin, për të siguruar përafrimin me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, sidomos me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sugjerimet dhe gjetjet e dhëna në këtë DU janë rezultat i analizimit të raporteve, legjislacionit ndërkombëtar, jurisprudencës, kuadrit legjislativ/rregullator dhe takimeve në internet të mbajtura mes tre ekspertëve ndërkombëtarë.

Legjislacioni shqiptar i konsultuar ishte një përkthim jozyrtar në anglisht i ofruar nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa Këshilli i Evropës gjithashtu siguroi përkthimin jozyrtar në anglisht të akteve nënligjore dhe vendimeve gjyqësore. Prandaj, mund të ketë disa pasaktësi në analizë krahasuar me tekstin origjinal si rezultat i këtij përkthimi.

Siç u përmend në kapitullin "çështje ndërsektoriale" më poshtë, të dhënat statistikore të ofruara ishin të kufizuara dhe analiza e kryer mund të ketë kufizime që rrjedhin nga mungesa e informacionit të detajuar mbi zbatimin e ligjit në praktikë.

Rekomandime kryesore:

Rekomandimet kryesore të formuluar janë si më poshtë:

I. Bazat dhe garancitë ligjore

1. Shkaqet dhe vendimi për paraburgim

- **Qartësimi i koncepteve të paqarta ligjore** - të formulohen përkufizime të qarta ligjore ose udhëzime gjyqësore për terma të paqarta siç janë " shkaqe të një rëndësie të veçantë " ose "rrezikshmëria e veçantë" (Nenet 228–230 të KPP-së).
- **Përafrimi i terminologjisë me standardet ndërkombëtare** dhe Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/681,² duke siguruar parashikueshmëri dhe siguri juridike.
- **Miratimi i kufijve të qartë të veprave penale për paraburgim** - të vlerësohet ndryshimi i KPP për të prezantuar një kufi minimal dënimi me burgim për të urdhëruar paraburgimin (në këtë DU propozohet një kufi tre-vjeçar, por të paktën një vit, siç rekomandohet në Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/681).
- **Forcimi i kërkesave të arsyetimit gjyqësor** - të zbatohet neni 245 i KPP duke kërkuar që gjyqtarët të bëjnë arsyetim individual dhe specifik për rastin kur urdhërojnë paraburgimin.
- **Prezantimi i mjeteve të strukturuar të vlerësimit të riskut** për të mbështetur gjyqtarët në vlerësimin nëse masat më pak ndërhyrëse mund t'i adresojnë risqet mjaftueshëm.
- **Gjykatat të dokumentojnë në mënyrë të qartë në vendime** pse masa të tilla si garancia pasurore, detyrimi për t'u paraqitur ose mbikëqyrja elektronike do të ishin të pamjaftueshme.

²[Rekomandimi i Komisionit \(BE\) 2023/681](#) i 8 dhjetorit 2022 mbi të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të të akuzuarve që i nënshtrohen paraburgimit dhe mbi kushtet materiale të paraburgimit, OJ L 86, 24.3.2023.



2. Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore

- **Përmirësimi i cilësisë së arsyetimit gjyqësor** - të ofrohet trajnim dhe monitorim për të siguruar që vendimet për paraburgimin të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe të individualizuar dhe jo referenca mekanike - arsyetimi duhet të adresojë në mënyrë të qartë arsyen pse alternativat janë të papërshtatshme dhe pse paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm.
- **Investimi në rritjen e kapaciteteve gjyqësore** - të zhvillohet trajnim i vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët.
- **Zgjatja e afatit për paraqitjen e ankimit ndaj vendimeve të paraburgimit nga pesë në dhjetë ditë.**
- **Forcimi i kontrollit në apel** - të rritet efektiviteti i mekanizmave të apelit duke siguruar që gjykatat e apelit të shqyrtojnë me rigorozitet arsyetimin e shkallës së parë.
- **Qartësimi i objektit të shqyrtimit në apel** - të ndryshohet neni 249 i KPP-së për të shprehur në mënyrë të qartë që gjykatat e apelit duhet të shqyrtojnë si elementët faktikë ashtu edhe elementët ligjorë të vendimit të paraburgimit, duke përfshirë provat në dispozicion, shkaqet e pretenduara (rreziku i largimit, rreziku i përsëritjes së veprës penale, pengimi i drejtësisë), proporcionalitetin e paraburgimit në lidhje me alternativat.
- **Garantimi i së drejtës për t'u dëgjuar në apel** - të kodifikohet që si i dyshuari ashtu edhe avokati i tij duhet të dëgjohen gjatë proceseve në apel.

3. Kohëzgjatja dhe shqyrtimi periodik i paraburgimit

- **Kufizimi i kohëzgjatjes maksimale** - Të vendosen afate kohore maksimale të rrepta që mund të tejkaloen vetëm në raste vërtet të jashtëzakonshme dhe vetëm kur mbështeten nga justifikime konkrete, të individualizuara dhe të mirë-arsyetuara.
- **Përmirësimi i standardeve të cilësisë së shqyrtimit** - të vendosen kritere më të forta për thellësinë, pavarësinë dhe arsyetimin e shqyrtimeve për të siguruar që ato të jenë thelbësore dhe jo formale.
- **Të garantohet që shqyrtimi periodik të përqendrohet në vlerësimin/shqyrtimin nëse paraburgimi është ende i nevojshëm, proporcional dhe i arsyeshëm dhe jo i bazuar vetëm në progresin e hetimit.**
- **Vendosja e një rregulli që përcakton një parim të përgjithshëm se prokurori duhet të kërkojë gjithashtu prova në favor të personit nën hetim dhe të informojë menjëherë gjykatën.**
- **Eliminimi i ndalimit kohor prej 6 muajsh para kundërshtimit të kohëzgjatjes së paraburgimit** (i vetmi kufizim duhet të jetë ndalimi i përsëritjes së argumenteve që janë paraqitur dhe diskutuar tashmë).
- **Të përcaktohet që afati kohor të fillojë në të njëjtin moment të masës së mëparshme të sigurimit edhe për akte të ndryshme të kryera para lëshimit të urdhrat të parë për të cilat ekziston një lidhje sipas nenit 55 të KP-së.**
- **Vendosja e një ekuivalence ndërmjet arrestit në shtëpi dhe paraburgimit dhe**



ndryshimi i zbritjes në dënimin përfundimtar, në mënyrë që një ditë paraburgimi/arrest në shtëpi të jetë e barabartë me një ditë në dënimin përfundimtar.

4. E drejta për avokat dhe garanci të tjera procedurale

- **Kodifikimi i garancive për heqjen dorë nga avokati** - nëse në sistemin shqiptar ekziston mundësia e heqjes dorë nga e drejta për mbrojtës, të ndryshohet KPP për të kërkuar që çdo heqje dorë nga e drejta për avokat të jetë e informuar, e qartë dhe vullnetare, të regjistrohet me shkrim (ose audio-video), pasi letra e të drejtave të jetë shpjeguar me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, dhe të jetë konfirmuar me nënshkrimin e të dyshuarit.
- **Forcimi i rolit të avokatit gjatë marrjes në pyetje** - të parashikohet qartë në KPP që avokatët mbrojtës mund të ndërhyjnë gjatë marrjes në pyetje për të mbrojtur interesin, për të kundërshtuar marrjen në pyetje të papërshtatshme dhe për të sqaruar keqkuptimet, duke siguruar ndihmë ligjore domethënëse - jo vetëm formale.
- **Garantimi i njohjes në kohë me materialet e çështjes** - të sigurohet që të dyshuarit dhe avokatët e tyre të njihen shpejt me dokumentet dhe provat thelbësore të nevojshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe përmbajtjen e akuzave.
- **Zbatimi i sistemeve të paanshme të avokatëve të gatshëm** - të krijohet sistemi i avokatëve të gatshëm 24/7, i menaxhuar nga dhoma e avokatëve, me kohë përgjigjeje të shpejtë, për të parandaluar ndikimin e policisë në përzgjedhjen e avokatëve dhe për të garantuar ndihmë juridike të menjëhershme dhe të pavarur.
- **Përmirësimi i ambienteve për ndihmë efektive** - të kërkohej hapësirë për konsultim privat në të gjitha komisaritet e policisë për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet avokatëve dhe të dyshuarve.
- **Detyrimi për regjistrimin audio-video të marrjes në pyetje nga policia** - të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i të gjitha marrjeve në pyetje, duke dokumentuar si praninë/pjesëmarrjen efektive të avokatëve ashtu edhe çdo heqje dorë nga të drejtat, për të garantuar drejtësinë procedurale dhe besueshmërinë e provave.

5. Alternativat ndaj paraburgimit

- **Përmirësimi i përdorimit të alternativave ndaj paraburgimit** - të garantohet që gjyqtarët sistematikisht të vlerësojnë dhe të zbatojnë masa më pak kufizuese përpara se të urdhërojnë paraburgimin, në përputhje me parimin e paraburgimit si masë e fundit.
- **Zgjerimi i objektit të regjimit të garancisë pasurore** - të zgjerohet zbatueshmëria e garancisë pasurore përtej rrezikut të largimit, duke e lejuar të shërbejë si një alternativë ndaj paraburgimit në rastet që përfshijnë rrezikun e përsëritjes së veprës penale ose pengimin e drejtësisë.
- **Mundësimi i garancisë pasurore në fazën fillestare të paraburgimit** - të ndryshohet KPP për të garantuar që gjykatat të vlerësojnë mundësinë e garancisë pasurore përpara se të urdhërojnë paraburgimin ose arrestin në shtëpi, në përputhje me



Nenin 5(3) të Konventës dhe Rregullat e Tokios të Kombeve të Bashkuara.

- **Krijimi i një sistemi mbikëqyrjeje elektronike efektiv dhe funksional**, duke ndjekur standardet e përcaktuara në Rekomandimin CM/Rec(2014)4 e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi monitorimin elektronik (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shkurt 2014, në takimin e 1192-të të Zëvendësministrave).
- **Zbatimi i plotë i Ligjit Nr. 10 494, datë 22.12.2011**, për mbikëqyrjen elektronike të personave, lëvizja e të cilëve është e kufizuar me vendim gjyqate, duke përdorur mjetet e nevojshme teknike dhe duke përshtatur Nenin 237, § 2 të KPP-së.
- **Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës** - të shtohen burimet, trajnimi dhe të forcohet autoriteti i organeve mbikëqyrëse përgjegjëse për monitorimin e respektimit të masave alternative.
- **Miratimi i ndalimit të kontaktit** - të ndryshohet Neni 232 i KPP-së për të përfshirë "ndalim të kontaktit me persona të caktuar".
- **Ndryshimi i nenit 57 të Kodit Penal**, duke e barazuar uljen e dënimit përfundimtar me ditët e kaluara në paraburgim, duke hequr shtesën që është aktualisht në fuqi.

6. Konsideratë Specifike për Personat në Situatë Vulnerabël

- Përcaktimi që paraburgimi i të **miturve** duhet të përdoret vetëm si masë e fundit; duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur dhe, kur paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm, të miturit duhet të mbahen veçmas të rriturve.
- **Përcaktimi i garancive procedurale për të miturit**: kufizimi i rasteve kur paraburgimi mund të jetë i zbatueshëm për të miturit, ndihma e detyrueshme kur urdhërohet ndalimi/paraburgimi; përshtatshmëria e avokatit; shpjegime të përshtatura.
- Për **gratë**, lejimi i grave shtatzëna të lindin në spital jashtë ambienteve të paraburgimit dhe të mbajnë fëmijët e mitur me vete (gjithmonë kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës).
- Përcaktimi që **shtetasit e huaj** të kenë të drejtën e informimit në lidhje me ndihmën ligjore dhe në lidhje me mundësitë e transferimit të dënimit.
- **Vendosja e masave kundër radikalizmit**; një sistem vlerësimi fillestar i rrezikut për të dyshuarit terroristë/ekstremistë, së bashku me vlerësime të rregullta të rrezikut gjatë paraburgimit; trajnimi i stafit për të njohur shenjat e radikalizmit; zbatimi i programeve të rehabilitimit dhe de-radikalizmit.

7. Ankimimi dhe mjetet juridike

- **Rishikimi i kufizimeve dhe përjashtimeve** - të rishikohen përjashtimet kufizuese, të tilla si mohimi i kompensimit kur vendimi i gabuar është "shkaktuar tërësisht ose pjesërisht" nga personi.
- **Rishikimi i ligjit të posaçëm për kufijtë e kompensimit** - të përditësohet Ligji nr. 9381, datë 28.04.2005 për të siguruar që nivelet e kompensimit të jenë realiste dhe proporcionale me dëmin real. Kompensimi duhet të pasqyrojë në mënyrë adekuate dëmin pasuror dhe dëmin jo pasuror.



- **Trajtimi shprehimisht i arrestit në shtëpi me të njëjtat kushte.**
- **Garantimi i zbatimit efektiv të vendimeve të kompensimit** - të miratohen garanci që sigurojnë që vendimet e kompensimit të paguhën menjëherë, me afate ligjore dhe mekanizma për të parandaluar vonesat administrative.
- **Sigurimi i transparencës dhe aksesueshmërisë** - të parashikohen rregulla të qarta procedurale dhe udhëzime të aksesueshme për aplikuesit mbi mënyrën se si të paraqesin kërkesat për kompensim. Ndiurma ligjore duhet të jetë në dispozicion për të garantuar që personat në situatë vulnerabël të mund të kërkojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive.

II. Çështje Ndërsektoriale

1. Mbledhja e të dhënave

- **Kryerja e një studimi gjithëpërfshirës mbi paraburgimin**, duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe BE në dokumentin ["Instrumenti i Vlerësimit të Paraburgimit"](#).

2. Nevoja për një ndryshim në kulturën gjyqësore - një qasje globale

- **Përcaktimi i një strategjie institucionale që synon të ulë raportin e paraburgimit** në Shqipëri në nivele të pajtueshme me standardet e Këshillit të Evropës, me përcaktimin e vizionit, misionit dhe vlerave, nga të cilat rrjedhin objektiva të qarta strategjike, së bashku me personat përgjegjës dhe treguesit e vlerësimit.

Konkluzionet e këtij raporti do të diskutohen me Qeverinë Shqiptare në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së vazhdueshme të Këshillit të Evropës për reformën e legjislacionit penal.



2 HYRJE

2.1 Qëllimi, metodologjia dhe objekti

Qëllimi i këtij Dokumenti Udhëzues (DU) është të japë udhëzime parimore dhe të orientuara nga praktika për hartimin e dispozitave mbi paraburgimin në Kodin e Procedurës Penale (KPP). Ai synon të identifikojë standardet kryesore ligjore, garancitë dhe praktikën premtuese që duhet të mbështesin një sistem modern të procedurës penale, me fokus të veçantë në të drejtën e lirisë dhe përdorimin e masave që heqin lirinë. Ky dokument synon të informojë përpjekjet për hartimin e legjislacionit dhe reformën, duke siguruar që KPP të jetë plotësisht në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, si edhe me kërkesat e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata).

U ndërmorën **hapat e mëposhtëm metodologjikë**:

1. Rishikimi i standardeve ndërkombëtare dhe evropiane
2. Analiza e jurisprudencës së Gjykatës në lidhje me nenin 5 të Konventës
3. Analiza krahasuese e legjislacionit kombëtar
4. Shqyrtimi i praktikës së brendshme dhe jurisprudencës së përzgjedhur
5. Inputet institucionale dhe statistikore
6. Konsultimet me ekspertët: Ekspertët zhvilluan një sërë takimesh online për të diskutuar gjetjet, për të krahasuar perspektivat dhe për të formuluar konkluzione të përbashkëta.

Ky dokument udhëzues përqendrohet në aspektet ligjore dhe praktike të paraburgimit siç rregullohet në procedurën penale. Objekti përfshin identifikimin e parimeve kryesore për rregullimin e paraburgimit, të nxjerra nga standardet ndërkombëtare dhe evropiane dhe analizimin e praktikave të mira në hartimin e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore që mund të shërbejnë si modele ose pika referimi për reformën.

2.2 Përmbledhje e instrumenteve ligjore ndërkombëtare

Paraburgimi përdoret për t'iu referuar periudhës gjatë së cilës një personi i është hequr liria para gjykimit, duke përfshirë ndalimin nga policia, deri në përfundimin e gjykimit penal, duke përfshirë ankimimin³. Ai përkufizohet si izolim i urdhëruar nga gjykata ose i autorizuar ligjërisht i personave të dyshuar ose të akuzuar gjatë fazës para gjykimit të proceseve penale, që shtrihet nga momenti i procesit penal formal deri në fillimin e gjykimit ose zgjidhjen e çështjes.

Standardet që rregullojnë paraburgimin në thelb i referohen kuadrit të të drejtave ndërkombëtare të njeriut⁴, ndërsa standardet më të rëndësishme ndërkombëtare rrjedhin nga Konventa.

³Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (ZKBDK), [Manuali mbi Strategjitë për të Ulur Mbipopullimin në Burgje](#). E gjeni në www.unodc.org, (aksesuar më: 23/09/2025).

⁴Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)(1948); Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) (1966) - Nenet 9 dhe 14.



Parimet thelbësore janë "E Drejta për Liri" dhe "Prezumimi i Pafajësisë". Për më tepër, një nga parimet kryesore është që paraburgimi mund të urdhërohet vetëm kur është rreptësisht i nevojshëm dhe proporcional.

Neni 5 i Konventës parashikon më konkretisht masa mbrojtëse të detajuara dhe ka gjeneruar jurisprudencë të gjerë përmes Gjykatës. Neni 5 i Konventës përcakton shkaqet e pranueshme për paraburgimin dhe disa garanci procedurale, të cilat pasqyrohen në të gjitha sistemet ligjore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës.

Neni 5 i Konventës kërkon qartësisht që paraburgimi të urdhërohet vetëm nëse ekziston dyshim i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale ose kur është objektivisht e nevojshme që personi të sillet para një autoriteti kompetent ligjor për një vendim.

Çdo person i arrestuar duhet të sillet para një gjyqtari, vendimet e të cilit duhet të bazohen në arsyetim individual, jo në referenca të paqarta ose abstrakte për 'sigurinë publike'. Nevoja për të parandaluar kryerjen e një veprë të re penale ose rrezikun e largimit pasi është kryer një vepër penale janë faktorë kyç që duhen marrë parasysh për të urdhëruar paraburgimin.

Një nga aspektet e rëndësishme të Nenit 5 të Konventës dhe jurisprudencës përkatëse të Gjykatës është kohëzgjatja e paraburgimit. Gjykata është shprehur që autoritetet duhet të tregojnë 'kujdes të veçantë' në kryerjen e proceseve.

Nga jurisprudenca e Gjykatës, mund të nxirren tetë parime për arsyetimin e vendimeve të paraburgimit, përkatësisht⁵:

1. Urdhri i paraburgimit duhet të jetë i arsyetuar.
2. Arsyetimi nuk duhet të jetë 'i përgjithshëm dhe abstrakt'.
3. Autoritetet duhet të japin arsye 'relevante dhe të mjaftueshme' për vazhdimin e paraburgimit.
4. Ashpërsia e dënimit nuk është një arsye e pavarur për paraburgimin.
5. Sa më i gjatë të jetë paraburgimi, aq më i plotë është shqyrtimi gjyqësor.
6. Paraburgimi nuk duhet të përdoret për të parashikuar dënimin.
7. Gjyqtari duhet të vlerësojë alternativat ndaj paraburgimit.
8. Mbrojtja e paraqitur është një faktor i rëndësishëm në vendim.

Neni 6 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTHBE), i cili përfshin të drejtën e lirisë, pasqyron Nenin 5 të Konventës.

Brenda Bashkimit Evropian (BE), megjithëse theksohet 'njohja reciproke' dhe 'harmonizimi' brenda fushës së sigurisë dhe drejtësisë, paraburgimi mbetet pa standarde të harmonizuara në aspektin e kushteve konkrete.

Dokumenti kryesor i BE-së për paraburgimin është Rekomandimi i Komisionit (BE) 2023/681, i 8 dhjetorit 2022, mbi të drejtat procedurale të të dyshuarve dhe të të akuzuarve që i nënshtrohen paraburgimit dhe për kushtet materiale të paraburgimit⁶. Ai u jep udhëzime Shteteve Anëtare mbi miratimin e masave efektive, të përshtatshme dhe proporcionale për të

⁵ Bemelmans, J.H.B.; Jacobs, P.; Steenhuijsen, T.L.H., [Follow-up study on the reasoning for pre-trial detention](#), Universiteti Tilburg, Prill 2025. E gjeni në www.mensenrechten.nl (aksesuar më: 23/09/2025).

⁶ Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, L86/44, 24. 03.2023.



forcuar të drejtat e të dyshuarve dhe të të akuzuarve të cilëve u është hequr liria. Rekomandimi mbulon si garancitë procedurale gjatë paraburgimit ashtu edhe kushtet materiale të ndalimit. Ai gjithashtu sjell në vëmendje nenin 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE), i cili pohon se Bashkimi bazohet në respektin për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut.

Rekomandimi (BE) 2023/681 përfshin parimin që paraburgimi është masë e fundit që duhet të zbatohet. Shkaqet për paraburgim duhet të kufizohen në (a) rrezikun e largimit; (b) rrezikun e përsëritjes së veprës penale; (c) rrezikun që i dyshuari ose i akuzuari mund të ndërhyjë në administrimin e drejtësisë; ose (d) rrezikun e një kërcënimi ndaj rendit publik.

Garancitë e mëposhtme procedurale përfshihen në Rekomandimin (BE) 2023/681:

- Kërkesa për arsyetim
- Shqyrtimi periodik
- E drejta e të dyshuarit për t'u dëgjuar personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor
- E drejta e ankimit
- Kohëzgjatja e paraburgimit nuk duhet të kalojë dënimin që mund të caktohet

Përveç këtyre standardeve ndërkombëtare të lartpërmendura, disa Direktiva të BE-së gjithashtu sanksionojnë një sërë garancish në të drejtën penale, të tilla si e drejta për interpretim dhe përkthim, e drejta për informacion, e drejta për avokat dhe e drejta për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor. Këto direktiva përmbajnë gjithashtu kushtet materiale të të dyshuarve që i nënshtrohen paraburgimit. Të gjitha këto masa synojnë të garantojnë të drejtat themelore të personave në paraburgim.

Në nivelin e Kombeve të Bashkuara (OKB), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), ndër të tjera, inkurajon gjithashtu përdorimin e masave jo me burgim, siç janë lirimi me deklaram personal, garancia pasurore ose garantuesi, mbikëqyrja elektronike, kërkesat për detyrim paraqitje të rregullt ose kufizimet e udhëtimit.⁷

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe Rregulla Minimale Standarde të OKB-së që lidhen me paraburgimin.⁸ Rregullat e Tokios parashikojnë posaçërisht që alternativat ndaj paraburgimit duhet të përdoren në një fazë sa më të hershme të jetë e mundur. Paraburgimi nuk duhet të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme për të arritur objektivat e deklaruara në rregullin 5.1 dhe duhet të administrohet në mënyrë njerëzore dhe me respekt për dinjitetin e lindur të qenieve njerëzore.⁹

Rregullat e Tokios përcaktojnë edhe parime të tjera, të tilla si:

- Paraburgimi nuk duhet të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme
- Paraburgimi duhet të administrohet në mënyrë njerëzore dhe me respekt për dinjitetin e lindur të qenieve njerëzore

⁷ Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Komenti i Përgjithshëm nr. 35 (2014) për nenin 9 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike: Liria dhe siguria e personave*, Dok. OKB. CCPR/C/GC/35, 16 dhjetor 2014.

⁸ Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës) (2015); Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Masat Jo me burgim (Rregullat e Tokios) (1990); Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit) (1985).

⁹ Rregullat e Tokios, rregulli 6.2.



- Autori i veprës penale ka të drejtë të ankohe pranë një autoriteti gjyqësor ose autoriteti tjetër kompetent të pavarur në rastet kur urdhërohet paraburgimi dhe
- Masat jo me burgim që vendosin detyrime mbi autorin e veprës penale, të zbatuara para ose në vend të proceseve formale ose gjykimit, duhet të jepen me pëlqimin e autorit të veprës penale.



3 PARABURGIMI: BAZAT LIGJORE DHE GARANCITË

Nenet 227 deri në 269 të KPP-së (të ndryshuara disa herë gjatë viteve 1995 dhe 2017 për t'u përafruar me ndryshimet kushtetuese dhe standardet evropiane) përcaktojnë rregullat për menaxhimin e paraburgimit.

Duke pasur parasysh instrumentet ligjore ndërkombëtare të lartpërmendura dhe dokumentet që vendosin standarde, analiza e kërkesave të procedurës penale në fuqi të Shqipërisë do të bëhet duke u përqendruar në shtatë tema kryesore:

1. Shkaqet dhe vendimi për paraburgim.
2. Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore.
3. Kohëzgjatja dhe shqyrtimi periodik i paraburgimit.
4. E drejta për avokat dhe garanci të tjera procedurale.
5. Alternativat ndaj paraburgimit.
6. Konsiderata specifike për personat në situatë vulnerabël.
7. Ankimimi dhe mjetet juridike.

3.1 Shkaqet dhe vendimi për paraburgim

Rekomandimi Rec(2006)13 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi përdorimin e paraburgimit përcakton kushtet kur mund të urdhërohet paraburgimi dhe ofron garanci kundër abuzimit¹⁰. Pikat 3 deri në 5 të *Parimeve të Përgjithshme* dhe pikat 6 dhe 7 të *Justifikimit* përcaktojnë udhëzimet kryesore për shkaqet dhe ligjshmërinë e vendimit për paraburgim:

Parime të përgjithshme

3. [1] Duke pasur parasysh si prezumimin e pafajësisë ashtu edhe prezumimin në favor të lirisë, paraburgimi i personave të dyshuar për një vepër penale do të jetë përjashtim dhe jo normë.
[2] Nuk do të kërkohet me detyrim që personat e dyshuar për një vepër penale (ose grupe të veçantë të këtyre personave) të vendosen në paraburgim.
[3] Në raste individuale, paraburgimi do të përdoret vetëm kur është absolutisht i nevojshëm dhe si masë e fundit; nuk do të përdoret për arsye ndëshkuese.
4. Për të shmangur përdorimin e papërshtatshëm të paraburgimit, do të vihet në dispozicion gama më e gjerë e mundshme e masave alternative, më pak kufizuese në lidhje me sjelljen e një të dyshuari.
5. Personat në paraburgim do t'i nënshtrohen kushteve të përshtatshme për statusin e tyre ligjor; kjo nënkupton mungesën e kufizimeve përveç atyre që janë të nevojshme për administrimin e drejtësisë, sigurinë e institucionit, sigurinë e të burgosurve dhe stafit dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në veçanti përmbushjen e kërkesave të Rregullave Evropiane të Burgjeve dhe rregullave të tjera të përcaktuara në Pjesën III të këtij teksti.

¹⁰ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 shtator 2006 në takimin e 974 të të zëvendësministrave. E gjeni në www.coe.int, (aksesuar më: 23/09/2025).



Justifikimi

6. Paraburgimi në përgjithësi do të përdoret vetëm në lidhje me personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale që dënohen me burg.
7. Një person mund të mbahet në paraburgim vetëm kur plotësohen të katër kushtet e mëposhtme:
- ekziston shkak i arsyeshëm për të dyshuar që ai ose ajo ka kryer një vepër penale; dhe
 - ka arsye thelbësore për të besuar se, nëse lirohet, ai ose ajo do të (i) fshihet, ose (ii) do të kryejë një vepër të rëndë penale, ose (iii) do të ndërhyjë në administrimin e drejtësisë, ose (iv) do të paraqesë kërcënim serioz për rendin publik; dhe
 - nuk ka mundësi të përdoren masa alternative për të adresuar shqetësimet e përmendura në b.; dhe
 - ky është një hap i ndërmarrë si pjesë e procesit të drejtësisë penale.

Sipas procedurës penale shqiptare, vendosja e masave të sigurimit personal udhëhiqet nga parimet e përshtatshmërisë, proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, duke qenë kështu në një masë të madhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, disa koncepte dhe terminologjia e përdorur shpesh janë shumë të paqarta dhe u mungon zhvillimi - **duhet të zhvillohen kritere konkrete për shkaqe disi të paqarta si "shkaqe të një rëndësie të veçantë" ose "rrezikshmëria e veçantë"**.

Neni 228 i KPP-së parashikon tre shkaqe për paraburgimin si një nga masat e sigurimit, përkatësisht: rreziku për ndikim te provat, rreziku i largimit dhe rreziku që i pandehuri të kryejë krime të rënda të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai/ajo po ndiqet penalisht. Këto shkaqe janë në përputhje me standardet e Konventës. Megjithatë, gjykatat kritikohen për përdorimin e këtyre shkaqeve në terma të përgjithshme. Thuhet se mungojnë vlerësimet e nevojshme konkrete dhe individuale.

Megjithatë, *dyshimi i arsyeshëm* kundër një të dyshuari i kërkuar nga paragrafi i parë i nenit 228 të KPP-së si kusht për miratimin e masave të sigurimit nuk duket se është një standard i përshtatshëm: *dyshimi i arsyeshëm* është një standard më i lartë se *dyshimi i thjeshtë*, por që nuk arrin nivelin e provave rrethanore reale (ose indicje)¹¹. Prandaj, koncepti i *dyshimit të arsyeshëm* është më afër fushës së masave parandaluese administrative se sa procedurës penale. Standardi i *dyshimit të arsyeshëm* është i krahasueshëm me standardin e përdorur në nenin 222 për autorizimin e përgjimeve dhe, është e qartë se e njëjta kërkesë minimale nuk mund të zbatohet si për mbledhjen e provave ashtu edhe për heqjen e lirisë së personit. **Do të preferohej që në nenin 228 të KPP-së të përdorej formulimi "shkaqe të arsyeshme të bazuara në prova" ose "indicie të rëndësishme", në vend të "dyshim i arsyeshëm"**. Ky riformulim madje do ta bënte të qartë që metodologjia bazë e vlerësimit është e njëjtë si për një vendim mbi fajësinë ashtu edhe për masat e sigurimit.

Neni 229 i KPP-së (vlerësimi i përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit të secilës masë duke pasur parasysh nevojat e sigurimit të rastit specifik, rëndesën e veprës penale, sanksionin e përcaktuar dhe rrethanat rënduese ose lehtësuese) dhe 230 i KPP-së (përdorimi i paraburgimit

¹¹Në lidhje me këtë, shihni paragrafin e dytë të nenit 152 (Çmuarja e provave): 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga provat rrethanore/indicjet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.



vetëm kur masat e tjera janë të papërshtatshme dhe kufizimi për paraburgimin e personave në situatë vulnerabël) duket se janë në përputhje me parimin që paraburgimi duhet të shërbejë si një *extrema ratio* dhe të kufizohet vetëm në raste të rënda dhe vetëm kur nuk mjaftojnë masat më pak të rënda.

Megjithatë, duhet theksuar se, ndryshe nga Rekomandimi i Komisionit (BE) 2023/681, i 8 dhjetorit 2022, i cili inkurajon Shtetet Anëtare të vendosin paraburgimin vetëm për veprat penale të dënueshme me dënim minimal me burgim prej një viti¹², KPP i Shqipërisë nuk e përcakton një kufi të tillë.

KPP i Shqipërisë, duke parashikuar që çdo vepër penale konsiderohet e dënueshme me burgim¹³, jo vetëm që nuk është në përputhje me Nenin 6 të Konventës - i cili parashikon që veprat penale të dënueshme me burgim duhet të renditen në një kategori më të rëndë - por gjithashtu krijon mungesë koherence, sepse neni 241 i KPP parashikon që masat ndaluese¹⁴ "mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit". Me fjalë të tjera, nuk është koherente që masat më pak të rënda të kërkojnë kushte më të rrepta zbatimi se masat më të rënda. Një tjetër kontradiktë mund të gjendet gjithashtu ndërmjet rregullit të lartpërmendur dhe pjesës së dytë të paragrafit 2 të nenit 229 të KPP-së: nëse masa e paraburgimit nuk mund të urdhërohet kur gjykata vlerëson që vepra penale në fjalë mund të rezultojë në dënim me kusht (duke ndaluar kështu përdorimin e tij për vepra të lehta penale), mospërcaktimi i një kufiri minimal në ligj është i papajtueshëm.

Ky hendek dhe kjo mospërputhje mund të zgjidhet duke futur një dispozitë specifike rregullatore në lidhje me masat shtrënguese, në veçanti arrestin në burg, njësoj me atë të përcaktuar në nenin 241 të KPP-së të lartpërmendur për masat e ndaluese.

Kjo dispozitë e mundshme rregullatore mund të përbëhet nga tre paragrafë të rinj të shtuar në nenin 232 të KPP-së, të formuluar si më poshtë:

Paragrafë të rinj për t'u shtuar në nenin ekzistues 232 të KPP-së:

2. Përveç rasteve të parashikuara nga dispozita të veçanta, në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni dhe në nenin 251¹⁵, masat e parashikuara në paragrafin e parë mund të zbatohen vetëm kur zhvillohen procedime për krime për të cilat ligji përcakton dënim me burgim të përjetshëm ose me një afat maksimal burgimi prej më shumë se tre vjetësh.
3. Arresti në burg mund të caktohet vetëm për krime, të kryera apo të mbetura në tentativë, për të cilat është caktuar një afat maksimal burgimi jo më pak se pesë vjet.
4. Dispozitat e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 nuk zbatohen për atë që ka shkelur dispozitat që lidhen me një masë sigurimi¹⁶.

Neni 245 i KPP-së përcakton kërkesa të hollësishme për vendimet e gjykatës për paraburgimin dhe, të paktën në letër, ofron një kuadër të fortë ligjor. Dispozita i detyron gjyqtarët të përcaktojnë shkaqe specifike që përlligjin paraburgimin, të shpjegojnë pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja dhe të tregojnë pse masat alternative

¹² Paragrafi (21).

¹³ Shihni nenet 232 dhe 244 të KPP-së që përcaktojnë se nuk ka një kufi minimal të ndëshkueshmërisë për masat e sigurimit.

¹⁴ Neni 227 i KPP thekson se "Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese".

¹⁵ Neni 251 rregullon arrestimin *in flagrante delicto* nga oficerët e policisë gjyqësore dhe agentët, si edhe nga shtetasit privatë.

¹⁶ Në lidhje me këtë, shihni nenin 231 (Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal).

konsiderohen të papërshtatshme, dhe mosrespektimi e bën vendimin të pavlefshëm. Megjithatë, në praktikë, cilësia e zbatimit duhet të përmirësohet.

Gjykatat shqiptare shpesh nuk arrijnë të bëjnë analizën e kërkuar konkrete, specifike për rastin, duke u mbështetur në vend të kësaj në referenca abstrakte për faktorë të tillë si "rëndesa e veprës penale" ose "natyra kriminale" e të pandehurit.

Formulimi i nenit 245, § 1, ç) e vendos arrestin në shtëpi dhe arrestin në burg në të njëjtin nivel, edhe pse ato kanë pasoja shumë të ndryshme mbi të dyshuarin dhe mbi burimet shtetërore. Kjo mund të rrezikojë parimin e paraburgimit si mjet i fundit, pasi ekziston një mospërputhje logjike ndërmjet nenit 230 dhe nenit 245, § 1, pika ç). Një zgjidhje e mundshme mund të jetë që në vendimin e gjykatës të kërkohej shkaqe specifike në lidhje me domosdoshmërinë e paraburgimit. Prandaj, ekspertët sugjerojnë **zëvendësimin e rreshtit të lartpërmendur në pikën ç) të § 1 të nenit 245 të KPP-së, me sa vijon:**

"ç) gjykata kur cakton masën e sigurimit arrest në burg duhet të tregojë shkaqet specifike pse e konsideron arrestin në shtëpi të papërshtatshëm në rastin konkret, me procedurat e kontrollit të përmendura në nenin 237".

Rekomandime

- **Qartësimi i koncepteve ligjore të paqarta** - të formulohen përkufizime të qarta ligjore ose udhëzime gjyqësore për terma të paqarta siç janë "shkaqe të një rëndësie të veçantë" ose "rrezikshmëria e veçantë" (Nenet 228–230 të KPP-së).
- **Përafrimi i terminologjisë me standardet ndërkombëtare dhe Rekomandimin (BE) 2023/681**, duke siguruar parashikueshmëri dhe siguri juridike.
- **Miratimi i kufijve të qartë të veprave penale për paraburgimin** - të vlerësohet ndryshimi i KPP për të futur një kufi minimal dënimi me burgim për të urdhëruar paraburgimin (në këtë DU propozohet një kufi tre-vjeçar, por të paktën një vit, siç rekomandohet në Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/681).
- **Forcimi i kërkesave të arsyetimit gjyqësor** - të zbatohet neni 245 i KPP duke kërkuar që gjyqtarët të bëjnë arsyetim individual dhe specifik për rastin kur urdhërojnë paraburgimin.
- **Prezantimi i mjeteve të strukturuar të vlerësimit të riskut** për të mbështetur gjyqtarët në vlerësimin nëse masat më pak ndërhyrëse mund t'i adresojnë risqet mjaftueshëm.
- **Gjykatat të dokumentojnë në mënyrë të qartë në vendime** pse masa të tilla si garancia pasurore, detyrimi për t'u paraqitur ose mbikëqyrja elektronike do të ishin të pamjaftueshme.

3.2 Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore

Siç u përmend në përmbledhjen e instrumenteve ligjore ndërkombëtare dhe në dokumentet përcaktuese të standardeve, e drejta ndërkombëtare kërkon që çdo heqje lirie të jetë e ligjshme, jo-arbitrarë dhe t'i nënshtrohet shqyrtimit të menjëhershëm gjyqësor.



Rekomandimi i Komitetit të Ministrave i lartpërmendur Rec(2006)13 përcakton standardet përkatëse të mëposhtme në lidhje me vendimin gjyqësor:

13. *Përgjegjësia për vendosjen në paraburgim, autorizimin e vazhdimet të tij dhe vendosjen e masave alternative i takon një autoriteti gjyqësor.*
18. *Çdo person i vendosur në paraburgim, si dhe çdokush që i nënshtrohet një zgjatjeje të paraburgimit ose masave alternative, ka të drejtë të ankohet kundër këtij vendimi dhe duhet të informohet për këtë të drejtë kur të merret ky vendim.*
21. [1] *Çdo vendim i një autoriteti gjyqësor për të vënë dikë në paraburgim, për të vazhduar qëndrimin në paraburgim ose për të vendosur masa alternative duhet të jetë i arsyetuar dhe personit të prekur duhet t'i jepet një kopje e shkaqeve.*
[2] *Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme shkaqet nuk do të njoftohen në të njëjtën ditë me vendimin.*

Sipas legjislacionit shqiptar, përdorimi i paraburgimit rregullohet nga garanci të përshtatshme: ai mund të urdhërohet vetëm nga gjykata¹⁷ me kërkesë të Prokurorit ose, në rast arrestimi nga Policia¹⁸ apo ndalimi të urdhëruar nga Prokurori ose Policia¹⁹, mund të miratohet nga gjykata brenda 96 orëve nga momenti i heqjes së lirisë²⁰. Ky mekanizëm garanton mbikëqyrje të hershme gjyqësore dhe minimizon rrezikun e ndalimit arbitrar. Për më tepër, masa e vendosur nuk mund të tejkalojë ashpërsinë e asaj të kërkuar nga Prokurori, ndërsa gjykata mund ta refuzojë kërkesën e Prokurorit, ta revokojë masën ose të caktojë një masë më pak të rëndë.

Vendimet e gjykatës që caktojnë masën e sigurimit arrest në burg duhet të jenë të arsyetuara siç duhet dhe duhet të përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara me ligj, duke përfshirë shkaqet faktike dhe ligjore që përlligjin domosdoshmërinë e paraburgimit. Nuk mjafton vetëm referenca që i bëhet kërkesës së prokurorit - Gjykata, edhe pse mund të transkriptojë dhe raportojë atë që është shkruar nga Prokurori, duhet të tregojë se ka kryer një vlerësim autonom dhe një analizë kritike të materialit provues dhe nevojave të sigurimit dhe të shkaqeve pse i konsideron ato të përshtatshme për të mbështetur zbatimin e masës.

Në këtë këndvështrim dhe **përveç ndryshimit të sugjeruar më sipër në "Shkaqet dhe vendimi për Paraburgim" (në shkronjën ç) të paragrafit 1), ekspertët sugjerojnë ndryshimin e shkronjës c) paragrafit 1 të nenit 245 (Vendimi i Gjykatës) si më poshtë:**

"c) vlerësimin autonom të shkaqeve të posaçme dhe të dhënat që përlligjin masën e sigurimit;"

Sistemi i mjeteve juridike përforcon më tej këto garanci (shihni nenin 249 të KPP-së). Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës. Gjykata e apelit duhet ta shqyrtojë çështjen brenda dhjetë ditëve, duke siguruar kështu një mjet të shpejtë dhe efektiv. Përveç kësaj, kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet rekurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë duke siguruar një nivel përfundimtar të shqyrtimit gjyqësor.

¹⁷ Shihni nenin 244 KPP.

¹⁸ Shihni nenin 251 KPP.

¹⁹ Shihni nenin 253 KPP.

²⁰ Shihni nenet 258 -259 KPP.

Neni 5, paragrafi 4 i Konventës sanksionon të drejtën e çdokujt për të kundërshtuar paraburgimin dhe ky mjet i brendshëm juridik, sipas jurisprudencës së Gjykatës, duhet të jetë efektiv. Bazuar në këtë jurisprudencë, ekspertët besojnë se afati pesë-ditor për të paraqitur ankimin për të kundërshtuar një vendim për caktimin e paraburgimit nuk është i mjaftueshëm. Pesë ditë është një periudhë shumë e kufizuar kohore për të marrë kopjen dhe për t'u njohur me të gjithë materialin provues - i cili mund të përbëhet nga një numër i madh faqesh -, për të zhvilluar konsultime avokat-person i dyshuar, për të kërkuar prova të dobishme për të rrëzuar dyshimin e arsyeshëm ndaj të akuzuarit dhe për të paraqitur një ankim të mirëarsyetuar. Ekspertët besojnë se ky afat duhet të zgjatet në dhjetë ditë, në mënyrë që ky mjet i brendshëm juridik të jetë efektiv. Për këtë qëllim, **paragrafi i parë i nenit 249 të KPP-së duhet të ndryshohet si më poshtë:**

"1. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës."

Një çështje tjetër në lidhje me ankimin kundër një vendimi gjykate për caktimin e një mase sigurimi është mungesa e qartësisë së objektit të shqyrtimit nga gjykata më e lartë. Do të ishte e këshillueshme që ligji të përcaktojë qartë që objekt i këtij shqyrtimi janë elementët faktikë, provat në dispozicion, çdo masë e vendosur dhe proporcionaliteti i arrestimit.

Një çështje tjetër problematike është që Gjykatës së Apelit nuk i është dhënë fuqia për të urdhëruar lirimin e menjëhershëm të personit të paraburgosur. Kjo jo vetëm që është joefikase, pasi krijon vonesa, por mund të çojë në paraburgim për një kohë më të gjatë se sa është e nevojshme.

Gjithashtu, ndërsa paragrafi 6 i nenit 249 përcakton se Gjykata mund të vendosë *për shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit*, është e rëndësishme të garantohet që të respektohen të drejtat e mbrojtjes dhe që të mund të kontestohen në mënyrë të duhur shkaqet e reja para vendimit të apelit.

Në këtë kuptim, ekspertët sugjerojnë që **neni 249, paragrafi 4 të riformulohet si më poshtë:**

"Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të paktën tri ditë përpara dhe ata dëgjohen nëse paraqiten në seancë. Nëse paraqiten prova ose të dhëna të reja nga prokurori, i pandehuri mund të kërkojë shtyrje të seancës për t'i shqyrtuar ato".

Rekomandime

- **Përmirësimi i cilësisë së arsyetimit gjyqësor** - të ofrohet trajnim dhe monitorim për të siguruar që vendimet për paraburgimin të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe të individualizuar dhe jo referenca mekanike - arsyetimi duhet të adresojë në mënyrë të qartë arsyen pse alternativat janë të pamjaftueshme dhe pse paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm.
- **Investimi në forcimin e kapaciteteve gjyqësore** - të zhvillohet trajnim i vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët.
- **Zgjatja e afatit për paraqitjen e ankimit ndaj vendimeve të paraburgimit nga pesë në dhjetë ditë.**



- **Forcimi i kontrollit në apel** - të rritet efektiviteti i mekanizmave të apelit duke siguruar që gjykatat e apelit të shqyrtojnë me rigorozitet arsyetimin në shkallën e parë.
- **Qartësimi i objektit të shqyrtimit në apel** - të ndryshohet neni 249 i KPP-së për të shprehur në mënyrë të qartë që gjykatat e apelit duhet të shqyrtojnë si elementët faktikë ashtu edhe elementët ligjorë të urdhrit të paraburgimit, duke përfshirë provat në dispozicion, shkaqet e pretenduara (rreziku i largimit, rreziku i përsëritjes së veprës penale, pengimi i drejtësisë), proporcionalitetin e paraburgimit në lidhje me alternativat.
- **Garantimi i së drejtës për t'u dëgjuar në apel** - të kodifikohet që si i dyshuari ashtu edhe avokati i tij duhet të dëgjohen gjatë proceseve në apel.
- **Prezantimi i fleksibilitetit të kufizuar në afatet kohore** - të mbahet afati dhjetë-ditor për shqyrtimin në apel, por të lejohet zgjatja e përcaktuar ngushtësisht me kërkesë të mbrojtjes.
- **Fuqizimi i gjykatave të apelit për të urdhëruar lirin e menjëhershëm.**
- **Garantimi i të drejtave të mbrojtjes kur paraqiten shkaqe të reja** - nëse gjykatat e apelit mund ta mbështetin vendimin e tyre në shkaqe të tjera përveç atyre të ngritura para gjykatës që cakton masën, KPP duhet të kërkojë që të njoftohet mbrojtja dhe t'i jepet mundësia për të kundërshtuar këto shkaqe të reja.

3.3 Kohëzgjatja dhe shqyrtimi periodik i paraburgimit

Neni 5, paragrafi 3 i Konventës është standardi kryesor në lidhje me 'kohën e arsyeshme' të paraburgimit. Pas ndalimit fillestar bazuar në dyshim të arsyeshëm, vazhdimi i ndalimit duhet të justifikohet me "arsye relevante dhe të mjaftueshme" që janë konkrete dhe të individualizuara. Konventa dhe Gjykata nuk vendosin rregulla të rrepta në lidhje me kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit. Nga vlerësimet rast pas rasti, mund të formulohen disa parime konkrete, të tilla si nevoja për rivlerësim të rregullt të domosdoshmërisë së paraburgimit, pamjaftueshmëria e mbështetjes vetëm në justifikimin fillestar, nevoja për të vlerësuar rrethana të reja dhe standarde të përmirësuara të cilësisë në lidhje me vlerësimin individual.

Në këtë drejtim, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Rec(2006)13 përcakton sa vijon:

17. [1] *Ekzistenca e justifikimit të vazhdueshëm për mbajtjen në paraburgim të një personi rishikohet periodikisht nga një autoritet gjyqësor, i cili do të urdhërojë lirin e të dyshuarit për veprë penale kur gjen që nuk përmbushet më një ose më shumë kushte në Rregullat 6 dhe 7 a, b, c dhe d.*

[2] *Interwali ndërmjet shqyrtimeve normalisht nuk do të jetë më i gjatë se një muaj, përveçse kur personi në fjalë ka të drejtë të paraqesë dhe të kërkojë shqyrtimin, në çdo kohë, të kërkesës për lirim.*

[3] *Përgjegjësia për të siguruar që të kryhen këto shqyrtime i takon autoritetit të ndjekjes penale ose autoritetit gjyqësor hetimor, dhe në rast se nuk bëhet asnjë kërkesë nga autoriteti i ndjekjes penale ose autoriteti gjyqësor hetimor për të vazhduar mbajtjen në paraburgim, çdo person që i nënshtrohet kësaj mase do të lirohet automatikisht.*



23. *Çdo specifikim i periudhës maksimale të paraburgimit nuk do të çojë në mosmarrjen në konsideratë në intervale të rregullta të nevojës aktuale për vazhdimin e tij, në rrethanat e veçanta të një rasti të caktuar.*
24. *[1] Autoriteti i ndjekjes penale ose autoriteti gjyqësor hetimor kanë përgjegjësinë të veprojnë me kujdesin e duhur gjatë hetimit dhe të sigurojnë që të shqyrtohet vazhdimisht ekzistenca e çështjeve që mbështesin paraburgimin.*
33. *[1] Periudha e paraburgimit para dënimit, kudo që të jetë kaluar, zbritet nga kohëzgjatja e çdo dënimi me burgim të dhënë më pas.*
- [2] Çdo periudhë paraburgimi mund të merret parasysht në përcaktimin e dënimit të dhënë kur nuk është dënim me burgim.*
- [3] Natyra dhe kohëzgjatja e masave alternative të vendosura më parë mund të merren parasysht njësoj në caktimin e dënimit.*

Gjykata krijoi një kuadër të përforcuar për vlerësimin e justifikimit për zgjatjen e paraburgimit sipas nenit 5 § 3 të Konventës, duke vendosur kundër Shqipërisë në një rast që kishte të bënte me një periudhë paraburgimi për shtatë muaj²¹. Gjykata gjeti se, ndërsa dyshimi i arsyeshëm mbeti kusht i domosdoshëm për paraburgimin, autoritetet kombëtare nuk kishin arritur të ofronin shkaqe "të mjaftueshme" duke dhënë vetëm referenca të përgjithshme për rreziqet e manipulimit të provave dhe largimit pa specifikime konkrete. Në mënyrë kritike, Gjykata theksoi se gjykatat vendase duhet të shpjegojnë pse provat nuk mund të ishin mbledhur në fazat e mëparshme, të vlerësojnë me seriozitet masat alternative përtej deklaratave të thjeshta formale dhe të rivlerësojnë rregullisht nëse shkaqet e paraburgimit mbeten të vlefshme gjatë zhvillimit të procesit.

Vendimi përcakton se rrethanat personale - siç janë dorëzimi vullnetar dhe kthimi nga jashtë - duhet të peshohen siç duhet kur vlerësohet rreziku i largimit, dhe se vendimet për paraburgim kërkojnë justifikim konkret dhe në zhvillim e sipër dhe jo përsëritje klishe të shqetësimeve fillestare.

Ky vendim ngre ndjeshëm standardin e provës për paraburgimin në të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, duke kërkuar që autoritetet gjyqësore të japin arsyetim të detajuar dhe specifik për rastin dhe të tregojnë vlerësim të vërtetë të alternativave më pak kufizuese, duke forcuar kështu prezumimin e lirisë të sanksionuar në ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.

Nenet 246, §6, 249, §§8-9, 263, 264 dhe 265 të KPP-së, si dhe neni 57 i KP-së, rregullojnë mekanizmin e monitorimit, rregullimit dhe kompensimit të paraburgimit:

- Neni 246, §6 i vendos Prokurorit detyrimin për të informuar sistematikisht gjykatën mbi aktivitetin e kryer hetimor dhe nevojat e sigurimit;
- Neni 249, §§8-9 përcakton një ndalim kohor: paraburgimi mund të kundërshtohet përsëri pasi të kenë kaluar gjashtë muaj nga ekzekutimi i arrestimit;
- Neni 263 përcakton afatet kohore të paraburgimit²²;

²¹Gëlliqi kundër Shqipërisë, nr. 15468/23, 25 shkurt 2025.

²²Ato që zbatohen për fazën paraprake janë:

- deri në 3 muaj në rast të kundërvajtjeve penale.



- Neni 264 parashikon që, gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj. Në çdo rast, edhe në rastin e zgjatjes së afatit të paraburgimit, kohëzgjatja maksimale e paraburgimit nuk mund të kalojë tre vite ose gjysmën e dënimit maksimal të parashikuar për veprën penale që procedohet.
- Neni 265 i KPP-së i lejon gjykatës jo vetëm të zgjasë, por edhe të pezullojë afatet e lartpërmendura në rast të abuzimit të dyshuar të procesit ose shkeljes ligjore;
- Neni 57 i KPP-së parashikon që në rast dënimi, periudha e kaluar në paraburgim zbritet nga dënimi i dhënë, ku një ditë paraburgim llogaritet si një ditë e gjysmë burgim.

Duke pasur parasysh këtë kuadër ligjor, mund të vërehet se regjimi ligjor shqiptar është, në përgjithësi, në përputhje me standardet evropiane.

Megjithatë, mund të bëhen disa vërejtje.

Detyrimi që ka Prokurori për të informuar vazhdimisht gjykatën për aktivitetin hetimor të kryer duhet të lexohet së bashku me detyrimin e konfidencialitetit gjyqësor të sanksionuar në nenin 279 të KPP-së. Duhet të arrihet një ekuilibër në mënyrë që ky i fundit të mos rrezikohet nga i pari.

Neni 246, paragrafi 6 i KPP-së parashikon një shqyrtim periodik çdo dy muaj. Aktualisht, ky shqyrtim bazohet kryesisht (vetëm) në progresin e hetimit, ndërsa në thelb shqyrtimi duhet të përqendrohet në vlerësimin/shqyrtimin nëse paraburgimi është ende i nevojshëm, proporcional dhe i arsyeshëm. Kohëzgjatja e hetimit është një nga aspektet që duhet marrë parasysh në këtë vlerësim. Sidomos në rastet e zgjatjes së paraburgimit, jurisprudenca e Gjykatës kërkon shqyrtim të hollësishëm dhe jo miratim rutinë pa një analizë individuale specifike të rastit.

Një rregull që përcakton një parim të përgjithshëm parashikon që Prokurori jo vetëm që kryen të gjitha aktivitetet e nevojshme për të vendosur nëse do të fillojë apo jo procedimin penal, por ai/ajo duhet gjithashtu të kërkojë prova në favor të personit nën hetim dhe të informojë menjëherë gjykatën për këto prova.

Nisur nga këto vërejtje, **ekspertët sugjerojnë rishikimin e nenit 246, §6 të KPP-së si më poshtë:**

-
- deri në 6 muaj për krime të dënueshme deri në 10 vjet burgim.
 - deri në dymbëdhjetë muaj për krime të dënueshme jo më pak se 10 vjet deri në burgim i përjetshëm.

Afatet kohore të zbatuara në fazën e gjykimit para gjykatës së parë janë:

- deri në 2 muaj në rast të kundërvajtjeve penale.
- deri në 9 muaj për krime të dënueshme deri në 10 vjet burgim.
- deri në 12 muaj për krime të dënueshme jo më pak se 10 vjet deri në burgim të përjetshëm.

Afatet kohore të zbatuara në fazën e gjykimit para gjykatës së apelit janë:

- deri në 2 muaj në rast të kundërvajtjeve penale.
 - deri në 6 muaj për krime të dënueshme deri në 10 vjet burgim.
 - deri në 9 muaj për krime të dënueshme jo më pak se 10 vjet deri në burgim të përjetshëm.
-



“6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit, pa cenuar “Detyrimin për të ruajtur sekretin” të përcaktuar në nenin 279.

Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht.

Gjykata, pasi dëgjon palët, vlerëson nëse arrestimi është akoma i nevojshëm, proporcional dhe i arsyeshëm dhe merr vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.

Prokurori ka detyrën të kërkojë gjithashtu prova në favor të personit nën hetim dhe të informojë menjëherë gjykatën për këtë, me qëllim që të shmangë vazhdimin e një mase sigurimi të pabazuar ose jo më të nevojshme.”

Vendosja e një afati kohor prej 6 muajsh para kundërshtimit të kohëzgjatjes së paraburgimit (Neni 249, §§8-9) nuk është gjithashtu në përputhje me pikën 23 të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave Rec(2006)13, i cili kërkon marrjen parasysh të nevojës aktuale për vazhdimin e një mase sigurimi në intervale të rregullta, pavarësisht nga periudha maksimale e paraburgimit dhe po njësoj pavarësisht nga kufizime të tjera kohore. I vetmi kufizim duhet të ketë të bëjë me ndalimin e përsëritjes së argumenteve që janë paraqitur dhe diskutuar. Duke pasur këtë parasysh **Neni 249, §8 mund të riformulohet si më poshtë:**

“I pandehuri dhe avokati i tij/saj mbrojtës mund të paraqesin kërkesë në gjykatë për të shfuqizuar, revokuar ose zëvendësuar masën shtrënguese në bazë të elementeve të reja, si edhe mund të kundërshtojnë vendimin e gjykatës duke paraqitur një ankim në gjykatën e apelit”.

Neni 263, §8 i KPP-së në lidhje me akuzat e njëpasnjëshme, përcakton se afati kohor fillon në të njëjtin moment me masën e mëparshme të sigurimit vetëm në rast të ndryshimit të cilësimit ligjor të të njëjtit fakt dhe jo edhe për fakte të ndryshme të kryera para lëshimit të urdhrit të parë për të cilën ekziston një lidhje sipas nenit 55 të Kodit Penal.

Ekspertët sugjerojnë që **neni 263, § 8 i KPP-së të riformulohet si më poshtë:**

“Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, ose është kryer një fakt tjetër përpara lëshimit të urdhrit të parë për të cilin ka një lidhje sipas nenit 55 KP, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit.

Neni 57 i KP-së paraqet dy aspekte problematike:

- a) duke përcaktuar që një ditë paraburgim barazohet me një ditë e gjysmë burgim që zbritet nga dënimi i dhënë, nga njëra anë, të pandehurit dhe avokatët mund të nxiten të shfrytëzojnë sa më shumë të jetë e mundur arrestin në burg, dhe, nga ana tjetër, gjykata mund të nxitet të përdorë gjerësisht fuqinë e saj për të pezulluar afatet kohore



të përcaktuara në nenin 265 të KPP-së, duke kontribuar kështu në mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve²³;

- b) Arresti në shtëpi ka efektin e kufizimit të lirisë personale dhe në fakt neni 237, §5 i KPP-së lexon "*Koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit*". Nuk është e qartë se cila është metoda e llogaritjes për zbritjen e periudhës në arrest në shtëpi nga dënimi i dhënë. Neni 237, §4, që parashikon se: "*Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejnë rregullat e caktuara për paraburgimin*", do të çonte drejt një interpretimi të ekuivalencës mes arrestit në burg dhe arrestit në shtëpi për zbritjen nga dënimi. Aktualisht, jurisprudenca përkatëse mbi këtë temë është e paqartë, përveç një vendimi interesant të Gjykatës Kushtetuese²⁴. Në praktikë, rezultati mund të krijojë një nxitje surreale për të pandehurit dhe avokatët e tyre që të preferojnë paraburgimin. **Zgjidhja është që të barazohet shprehimisht paraburgimi me arrestin në shtëpi dhe, nëpërmjet një dispozite të qartë, të zbriten të dyja nga dënimi i dhënë sipas formulës një ditë paraburgimi është e barabartë me një ditë dënimi.**

Periudha maksimale e paracaktuar prej tre vjetësh për krime të rënda dhe dy vjet për krime të nivelit të mesëm është më shumë se sa nevojitet, veçanërisht si një parim i zbatueshëm në përgjithësi. Kjo skemë ligjore sigurisht që mund të shkaktojë tejkalim sistematik të periudhës së arsyeshme të paraburgimit. Mungon një mekanizëm i qartë me anë të të cilit justifikimi i paraburgimit afatgjatë t'i nënshtrohet kërkesave më të larta.

Sipas nenit 264, §2 të KPP-së, gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj. Koncepti i "nevojave të rëndësishme të sigurimit dhe verifikimeve veçanërisht komplekse" është shumë i paqartë. Gjithashtu, këtu, kërkesat për justifikim mungojnë ndërsa zgjatet kohëzgjatja e paraburgimit. Duhet të kërkojen arsye relevante dhe të mjaftueshme të mbështetura nga analiza konkrete individuale.

Rekomandime

- **Kufizimi i kohëzgjatjes maksimale** - të vendosen afate kohore maksimale të rrepta që mund të tejkalohen vetëm në raste vërtet të jashtëzakonshme dhe vetëm kur mbështeten nga justifikime konkrete, të individualizuara dhe të mirë-arsyetuara.
- **Përmirësimi i standardeve të cilësisë së shqyrtimit** - të vendosen kritere më të forta për thellësinë, pavarësinë dhe arsyetimin e shqyrtimeve për të siguruar që ato të jenë thelbësore dhe jo formale.

²³ Në këtë drejtim, shihni pikën 12 të Rekomandimit Nr. R (99) 22 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Inflacionin e Popullsisë së Burgjeve: 12. Duhet të përdoren sa më shumë alternativat ndaj paraburgimit, siç është kërkesa që i dyshuari të qëndrojë në një adresë të caktuar, kufizimi për t'u larguar ose për të hyrë në një vend të caktuar pa leje, dhënia e garancisë pasurore ose mbikëqyrja dhe ndihma nga një agjenci e specifikuar nga autoriteti gjyqësor. Në këtë drejtim, duhet t'i kushtohet vëmendje mundësive për mbikëqyrjen e kërkesës për të qëndruar në një vend të caktuar përmes pajisjeve të mbikëqyrjes elektronike.

²⁴ Shihni edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 40 të datës 16.06.2025 në lidhje me zbatimin e të njëjtave afate kohore për arrestin në burg dhe arrestin në shtëpi.

- Të sigurohet që shqyrtimi periodik të përqendrohet në vlerësimin/shqyrtimin nëse paraburgimi është ende i nevojshëm, proporcional dhe i arsyeshëm, dhe jo vetëm i bazuar në progresin e hetimit.
- Vendosja e një rregulli që përcakton një parim të përgjithshëm se prokurori duhet të kërkojë gjithashtu prova në favor të personit nën hetim dhe të informojë menjëherë gjykatën.
- Eliminimi i ndalimit kohor prej gjashtë muajsh para kundërshtimit të kohëzgjatjes së paraburgimit (i vetmi kufizim duhet të jetë ndalimi i përsëritjes së argumenteve që janë paraqitur dhe diskutuar tashmë).
- Vendosja që afati kohor të fillojë në të njëjtin moment të masës së mëparshme të sigurimit edhe për akte të ndryshme të kryera para lëshimit të urdhrit të parë për të cilat ekziston një lidhje sipas nenit 55 të KP-së.
- Vendosja e barazimit ndërmjet arrestit në shtëpi dhe arrestit në burg dhe ndryshimi i zbritjes në dënimin përfundimtar, në mënyrë që një ditë paraburgimi/arresti në shtëpi të jetë e barabartë me një ditë në dënimin përfundimtar.

3.4 E drejta për avokat dhe garanci të tjera procedurale

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Rec(2006)13 i kushton një kapitull specifik kësaj teme:

Ndihma nga avokati, prania e personit të interesuar dhe përkthimi

25. [1] Qëllimi për të kërkuar paraburgim dhe arsyet për ta bërë këtë duhet t'i komunikohen menjëherë personit të interesuar në një gjuhë që ai ose ajo e kupton.

[2] Personi, për të cilin kërkohet paraburgimi, ka të drejtë për ndihmë nga një avokat në proceset e paraburgimit dhe të ketë një mundësi të mjaftueshme për t'u konsultuar me avokatin e tij ose të saj në mënyrë që të përgatitë mbrojtjen e tij. Personi i interesuar duhet të njoftohet për këto të drejta në kohë të mjaftueshme dhe në një gjuhë që ai ose ajo e kupton, në mënyrë që ushtrimi i tyre të jetë i mundshëm.

[3] Kjo ndihmë nga një avokat duhet të ofrohet me shpenzime publike kur personi, për të cilin kërkohet paraburgimi, nuk mund ta përballojë atë.

[4] Ekzistenca e një emergjence në përputhje me nenin 15 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut normalisht nuk duhet të ndikojë në të drejtën për të pasur dhe për t'u konsultuar me një avokat në kontekstin e proceseve të paraburgimit.

26. Një person, për të cilin kërkohet paraburgimi, dhe avokati i tij ose i saj duhet të njihen me dokumentacionin përkatës për një vendim të tillë në kohën e duhur.

27. [1] Një person që është shtetas i një vendi tjetër dhe për të cilin kërkohet paraburgimi, ka të drejtë që konsulli i këtij vendi të njoftohet për këtë mundësi në kohë të mjaftueshme për të marrë këshilla dhe ndihmë prej tij ose saj.

[2] Kjo e drejtë, sa herë që është e mundur, duhet t'u ofrohet edhe personave që kanë shtetësinë edhe të vendit ku kërkohet paraburgimi i tyre, edhe të një vendi tjetër.



28. *Një person, për të cilin kërkohet paraburgimi, ka të drejtë të paraqitet në proceset për masën e sigurimit arrest në burg. Në kushte të caktuara, kjo kërkesë mund të përmbushet nëpërmjet përdorimit të lidhjeve të përshtatshme video.*
29. *Shërbime të përshtatshme përkthimi para autoritetit gjyqësor që shqyrton nëse personi duhet të vendoset në paraburgim, do të ofrohen me shpenzime publike, kur personi në fjalë nuk e kupton dhe nuk flet gjuhën e përdorur normalisht në ato procese.*
30. *Personave që paraqiten në proceset e caktimit të masës së sigurimit arrest në burg duhet t'u jepet mundësia të lahen dhe, në rastin e të burgosurve meshkuj, të rruhen, përveçse nëse ekziston rreziku që kjo të rezultojë në një ndryshim thelbësor të pamjes së tyre rë zakonshme.*
31. *Rregullat e mësipërme të kësaj pjese do të zbatohen edhe për vazhdimin e paraburgimit.*

Neni 6 i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës kërkojnë që të dyshuarit të informohen për të drejtat e tyre dhe të kenë avokat që nga marrja e parë në pyetje nga policia e më tutje. Mundësia e ndihmës efektive ligjore gjatë marrjes në pyetje duhet të garantohet dhe heqja dorë nga e drejta për avokat duhet të jetë e qartë, e informuar dhe vullnetare. Këto garanci minimale përforcohen nga disa Direktiva të BE-së, të cilat plotësojnë Konventën²⁵.

Nenet përkatëse në KPP të Shqipërisë janë nenet 246, § 4; 247, §3; 248, §3; 249, §1/1, 4 dhe 9; 255, §1; 256, §1; 258, § 2; 259, §1 dhe 2; dhe 264, §1 dhe 2. Duket se këto dispozita përmbushin të gjitha standardet dhe kërkesat evropiane, duke marrë parasysh detyrimet e ndryshme të njoftimit që kanë autoritetet për të siguruar ndihmën ligjore efikase.

Përtej KPP, Ligji nr. 111/2017 përcakton ndihmën juridike të garantuar nga shteti (parësore dhe dytësore) për çështjet penale dhe për grupet prioritare/vulnerabël.

Edhe pse KPP në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, mund të sugjerohen disa përmirësime me qëllim forcimin e të drejtës për mbrojtje.

Së pari, nëse sistemi shqiptar lejon heqjen dorë nga e drejta për avokat, **KPP duhet të kodifikojë shprehimisht kushtet sipas të cilave mund të pranohet heqja dorë nga e drejta për avokat.** Çdo heqje dorë duhet të jetë e informuar, e qartë dhe vullnetare, dhe duhet të dokumentohet në mënyrë të besueshme. Kjo kërkon që letra e të drejtave t'i dorëzohet të dyshuarit menjëherë pas heqjes së lirisë, t'i shpjegohet në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, dhe të përshtatet me nivelin e të kuptuarit të personit. Vetëm pasi letra e të drejtave të jetë shpjeguar plotësisht, heqja dorë mund të konsiderohet e vlefshme. Kjo heqje dore nga avokati duhet të konfirmohet me firmën e personit dhe, në rastin më të mirë, me regjistrim audio ose video, në mënyrë që të parandalohen mosmarrëveshjet në një fazë të mëvonshme të proceseve.

Së dyti, **roli i avokatit gjatë marrjes në pyetje duhet të përcaktohet më qartë dhe të forcohet.** KPP duhet ta bëjë të qartë që prania e avokatit mbrojtës nuk është pasive, por aktive, duke i mundësuar atij/asaj të ndërhyjë në marrjen në pyetje, me qëllim mbrojtjen e të drejtave ligjore, sqarimin e pyetjeve ose përgjigjeve dhe kundërshtimin e teknikave të papërshtatshme ose

²⁵ Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 majit 2012, për të drejtën e informimit në procese penale.

Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 tetorit 2013 mbi të drejtën për avokat në procese penale dhe në proceset e urdhër arrestit evropian, dhe mbi të drejtën për të informuar një palë të tretë për heqjen e lirisë dhe për të komunikuar me persona të tretë dhe me autoritetet konsullore gjatë heqjes së lirisë.

Direktiva (BE) 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 tetorit 2016 mbi ndihmën juridike për të dyshuarit dhe të akuzuarit në proceset penale dhe për personat e kërkuar në proceset e urdhër-arrestit evropian.



shtrënguese të marrjes në pyetje, dhe gjithashtu në momentin e vendimmarrjes për masën, me qëllim propozimin e alternativave ndaj paraburgimit, pa penguar efikasitetin e marrjes në pyetje. Për më tepër, të dyshuarve dhe avokatëve të tyre duhet t'u garantohet njohja në kohë me materialet e çështjes që janë thelbësore për të kundërshtuar si ligjshmërinë e paraburgimit ashtu edhe përmbajtjen e akuzës. Pa u njohur me to, e drejta për ndihmë efektive ligjore rrezikon të bëhet thjesht formale.

Së treti, **rregullimet praktike që lidhen me letrën e të drejtave dhe të drejtën për avokat duhet të përforcohen.** Duhet të garantohet shprehimisht që autoritetet policore të mos ndikojnë ose të mos i drejtojnë të dyshuarit drejt avokatëve specifikë. Përkundrazi, duhet të përdoret një listë avokatësh të gatshëm, ose një sistem digjital për caktimin, të menaxhuara nga dhoma e avokatisë, për të siguruar paanshmërinë, transparencën dhe pavarësinë e përfaqësimit ligjor. Ky sistem duhet të garantojë mbulim 24/7, me objektiva të rrepta për kontakt dhe pjesëmarrje të shpejtë. Gjithashtu, komisariatet e policisë duhet të ofrojnë hapësira private konsultimi për të siguruar konfidencialitetin e komunikimeve ndërmjet avokatit dhe klientit, gjë të cilën Gjykata e ka theksuar vazhdimisht si një aspekt themelor të së drejtës për mbrojtje. Për më tepër, regjistrimi audio-vizual i të gjitha rasteve të marrjes në pyetje duhet të prezantohet si një garanci e detyrueshme. Regjistrimet do të ofronin dokumentacion të besueshëm për praninë dhe pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës, heqjen dorë me dëshirë, dorëzimin dhe shpjegimin e duhur të letrës së të drejtave dhe drejtësinë e përgjithshme të procesit të marrjes në pyetje.

Të marra së bashku, këto reforma jo vetëm që do ta sillnin KPP të Shqipërisë më afër standardeve të Konventës dhe direktivave të BE-së, por gjithashtu do të forconin besimin në sistemin e drejtësisë penale duke siguruar që të drejtat e mbrojtjes së të dyshuarve - duke filluar me letrën e të drejtave dhe duke u shtrirë deri në përfaqësimin efektiv ligjor - të jenë kuptimplota dhe efektive në praktikë.

Rekomandime

- **Kodifikimi i garancive për heqjen dorë nga avokati** - të ndryshohet KPP-së për të kërkuar që çdo heqje dorë nga e drejta për avokat të jetë e informuar, e qartë dhe vullnetare, të regjistrohet me shkrim (ose audio-video), pasi letra e të drejtave të jetë shpjeguar me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, dhe të jetë konfirmuar me firmën e të dyshuarit.
- **Forcimi i rolit të avokatit gjatë marrjes në pyetje** - të parashikohet shprehimisht në KPP që prania e avokatit mbrojtës nuk është pasive, por aktive, duke i mundësuar atij/asaj të ndërhyjë në marrjen në pyetje, me qëllim mbrojtjen e privilegjit ligjor, sqarimin e pyetjeve ose përgjigjeve dhe kundërshtimin e teknikave të papërshtatshme ose shtrënguese të marrjes në pyetje, dhe gjithashtu në momentin e vendimmarrjes për masën, duke propozuar kur është rasti alternativa ndaj paraburgimit, pa penguar efikasitetin e marrjes në pyetje.
- **Garantimi i njohjes në kohë me materialet e çështjes** - të sigurohet që të dyshuarit dhe avokatët e tyre të njihen shpejt me dokumentet dhe provat thelbësore të nevojshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe përmbajtjen e akuzave.



- **Zbatimi i sistemeve të paanshme të avokatëve të gatshëm** - të krijohet sistemi i avokatëve të gatshëm 24/7, i menaxhuar nga dhoma e avokatëve, me kohë përgjigjeje të shpejtë, për të parandaluar ndikimin e policisë në përzgjedhjen e avokatëve dhe për të garantuar ndihmë juridike të menjëhershme dhe të pavarur.
- **Përmirësimi i ambienteve për ndihmë efektive** - të kërkohej hapësirë për konsultim privat në të gjitha komisaritet e policisë për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet avokatëve dhe të dyshuarve.
- **Detyrimi për regjistrimin audio-video të marrjes në pyetje nga policia** - të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i të gjitha marrjeve në pyetje, duke dokumentuar si praninë/pjesëmarrjen efektive të avokatëve ashtu edhe çdo heqje dorë nga të drejtat, për të garantuar drejtësinë procedurale dhe besueshmërinë e provave.

3.5 Alternativat ndaj paraburgimit

Standardet ndërkombëtare²⁶ shprehimisht kërkojnë që paraburgimi të përdoret si masë e fundit në procesin penal. Alternativat ndaj paraburgimit duhet të përdoren në një fazë sa më të hershme të jetë e mundur. Paraburgimi nuk duhet të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme. Neni 5 i Konventës njih rëndësinë e alternativave ndaj paraburgimit dhe Gjykata në mënyrë të përsëritur është shprehur që disa vendime të gjykatave të brendshme duhet të vlerësojnë masa "më pak ndërhyrëse" përpara se të urdhërojnë zgjatjen e paraburgimit.²⁷

Në nivelin e BE-së, "Konkluzionet e Këshillit mbi masat alternative ndaj paraburgimit: përdorimi i masave dhe dënimeve jo me burgim në fushën e drejtësisë penale (2019/C 422/06)"²⁸ i inkurajon shprehimisht Shtetet Anëtare që "të rrisin ndërgjegjësimin mes profesionistëve të ligjit për avantazhet e masave alternative ndaj paraburgimit, si dhe për disponueshmërinë dhe karakteristikat teknike të mjeteve ekzistuese, siç është mbikëqyrja elektronike". Në të njëjtën linjë, Komisioni Evropian, në Rekomandimin e tij (BE) 2023/681, të 8 dhjetorit 2022²⁹, shprehet qartë që "masat alternative ndaj paraburgimit duhet të preferohen, veçanërisht kur vepra penale dënohet vetëm me një dënim të shkurtër me burgim ose kur autori i veprës penale është i mitur", dhe për këtë qëllim, Shtetet Anëtare "duhet të vënë në dispozicion gamën më të gjerë të mundshme të masave alternative", duke përfshirë:

- (a) angazhimin për t'u paraqitur para një autoriteti gjyqësor sipas nevojës dhe kur kërkohej, mosndërhyrjen në rrjedhën e drejtësisë dhe mospërfshirjen në sjellje të caktuara, sidomos ato që përfshihen në një profesion ose punësim të caktuar;
- (b) kërkesa për t'u paraqitur çdo ditë ose periodikisht te një autoritet gjyqësor, policia ose një autoritet tjetër;
- (c) kërkesa për të pranuar mbikëqyrje nga një agjenci e caktuar nga autoriteti gjyqësor;
- (d) kërkesa për t'iu nënshtruar mbikëqyrjes elektronike;

²⁶ Neni. 6.1 dhe neni 6.2 Rregullat e Tokios të OKB-së, 1990; Neni. 10(2)a ICPCR.

²⁷ Buzadji kundër Republikës së Moldavisë, nr. 23755/07, 5 korrik 2016.

²⁸ Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, C422/13, 16/12/2019.

²⁹ Shihni shënimin 5.

- (e) kërkesa për të qëndruar në një adresë të caktuar, me ose pa kushte për orët që do të kalohen atje;
- (f) kërkesa për të mos u larguar ose hyrë në vende ose rrethe të caktuara pa leje;
- (g) kërkesa për të mos u takuar me persona të caktuar pa leje;
- (h) kërkesa për të dorëzuar pasaportat ose dokumente të tjera identifikimi; dhe
- (i) kërkesa për të ofruar ose siguruar garanci financiare ose forma të tjera garancish në lidhje me sjelljen në pritje të gjykimit.

Në nivelin e Këshillit të Evropës, standardet dhe kërkesat përcaktohen nga rekomandimet e mëposhtme:

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (99) 22, në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullsisë së burgjeve:³⁰

12. Duhet të përdoren sa më shumë alternativat ndaj paraburgimit, siç është kërkesa që i dyshuari të qëndrojë në një adresë të caktuar, kufizimi për t'u larguar ose për të hyrë në një vend të caktuar pa leje, dhënia e garancisë pasurore ose mbikëqyrja dhe ndihma nga një agjenci e specifikuar nga autoriteti gjyqësor. Në këtë drejtim, duhet t'i kushtohet vëmendje mundësive për mbikëqyrjen e kërkesës për të qëndruar në një vend të caktuar përmes pajisjeve të mbikëqyrjes elektronike.

Rekomandim i Komitetit të Ministrave Rec(2006)13³¹:

Preambula

Këto rregulla synojnë:

- b. të inkurajojnë përdorimin e masave alternative aty ku është e mundur;
- 33. [1] Periudha e paraburgimit para dënimit, kudo që të jetë kaluar, zbritet nga kohëzgjatja e çdo dënimi me burgim të dhënë më pas.
- [2] Çdo periudhë paraburgimi mund të merret parasysh në përcaktimin e dënimit të dhënë kur nuk është dënim me burgim.
- [3] Natyra dhe kohëzgjatja e masave alternative të vendosura më parë mund të merren parasysh njësoj në caktimin e dënimit.

Legjislacioni penal shqiptar duket se është në përputhje me këto kërkesa:

- Neni 230, paragrafi 1 shprehimisht artikulon se arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit;
- Neni 245 i KPP-së përfshin detyrimin që gjykata të japë shpjegime pse i konsideron të papërshtatshme masat e tjera të sigurimit; dhe nenet 232 deri në 239 të KPP-së parashikojnë dhe rregullojnë një gamë masash më pak kufizuese alternative ndaj paraburgimit, përfshirë, *inter alia*, arrestin në shtëpi, garancinë pasurore, detyrimin për t'u paraqitur rregullisht në polici, kufizimet e lirisë së lëvizjes.

³⁰ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 shtator 1999 në takimin e 681të të zëvendësministrave. E gjeni në <https://rm.coe.int/168070c8ad> (aksesuar më: 23/09/2025).

³¹ Shihni referencën më sipër.



Edhe pse kuadri ligjor është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, mund të bëhen disa vërejtje kritike.

Së pari, edhe pse neni 245 i KPP-së kërkon që gjyqtarët të japin shpjegim të qartë kur urdhërojnë paraburgimin, **ky detyrim shpesh përmbushet në mënyrë mjaft formale**.

Në legjislacion **nuk ekziston masa e veçuar 'ndalim i kontaktit' (urdhër për të mos kontaktuar)**, e cila është një nga alternativat thelbësore për të ulur rrezikun që i dyshuari ose i akuzuari të ndërhyjë në administrimin e drejtësisë duke bërë marrëveshje me të dyshuar të tjerë, viktimë ose palë të treta.

Edhe pse rregullimi i masës së **garancisë pasurore** mund të konsiderohet si një hap pozitiv, **fusha e zbatimit të saj për fat të keq është e ngushtë**. Neni 236 i KPP-së e lidh garancinë pasurore ekskluzivisht me rastet që përfshijnë rrezikun e largimit. Edhe pse garancia pasurore në fakt është instrumenti më i rëndësishëm për të ulur këtë risk, kjo nuk e përjashton përshtatshmërinë e saj si një masë alternative kur kërkohet paraburgimi për shkaqe të tjera. Një kufizim i mëtejshëm qëndron në kohën e garancisë: formulimi ligjor tregon se garancia pasurore mund të merret parasysh vetëm *pasi* të jetë dhënë vendimi për caktimin e arrestit në burg. Kjo qasje bie ndesh me Nenin 5, paragrafi 3 të Konventës dhe Rregullat e Tokios të OKB-së, të cilat kërkojnë që alternativat të vlerësohen *para* se të urdhërohet paraburgimi.

Për më tepër, rregullimi rrezikon të shkojë shumë larg në një aspekt tjetër: sipas nenit 236 të KPP-së, **shkelja e kushteve të garancisë pasurore, çon automatikisht në ricaktimin e masës së sigurimit arrest në burg**. Kjo ngurtësi nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë një përgjigje të shkallëzuar, duke lënë hapësirë për masa të tjera jo me burgim dhe jo caktimin e masës së sigurimit arrest në burg në çdo rast shkeljeje. Jo të gjitha shkeljet justifikojnë kthimin në paraburgim³².

Një koment më i përgjithshëm, i cili vlen për të gjitha alternativat e mundshme, është që **legjislacioni nuk përfshin një mekanizëm për rishikim periodik të masave të vendosura**. Ekziston një afat kohor, i ngjashëm me paraburgimin, por nuk ka rivlerësim automatik periodik. Megjithatë, edhe në këtë pikë, standardet ndërkombëtare, siç janë Rregullat e Tokios të OKB-së³³ dhe jurisprudenca e gjykatave³⁴, janë të qarta.

Sfida kryesore në lidhje me alternativat ndaj paraburgimit në Shqipëri qëndron në zbatimin e tyre nga gjykatat në praktikë.

Për më tepër, është thelbësore që alternativat të mbështeten nga një kuadër funksional që siguron efektivitetin e tyre në praktikë. Në këtë pikë, Shqipëria përballlet me mangësi të konsiderueshme, të cilat në mënyrë të kuptueshme ulin dëshirën e gjyqtarëve për t'u mbështetur në alternativa ndaj paraburgimit. Mungesa e sistemit funksional dhe të përshtatshëm të mbikëqyrjes elektronike në Shqipëri ngre shqetësime. Është thelbësore që ligji Nr. 10 494, i datës 22/12/2011, për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor, të zbatohet plotësisht dhe të bëhet një alternativë efektive në dispozicion të gjyqtarëve kur vendosin për masat kufizuese para procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, përveç nevojës për të vënë në praktikë mjetet teknike për të zbatuar atë ligj, ekspertët

³² *Sulaoja kundër Estonisë*, nr. 55939/00, 15 shkurt 2005.

³³ Neni 6.2 i Rregullave të Tokios të OKB-së.

³⁴ *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë*, 2016



sugjerojnë që në **paragrafin 2 të Nenit 237 të KPP-së, pas fjalës "mbikëqyrje", të shtohet sa vijon:**

"Kur cakton arrestin në shtëpi, edhe në vend të arrestit në burg, gjyqtari, përveçse nëse e konsideron të panevojshëm për shkak të natyrës dhe shkallës së nevojave paraprake që duhen përmbushur në rastin specifik, përshkruan procedurat e kontrollit me mjete elektronike ose mjete të tjera teknike të përmendura në ligjin Nr. 10 494 të 22.12.2011, me kusht që policia gjyqësore të bëjë verifikimin e funksionalitetit të tyre teknik, sidomos përdorimit operativ.

Me të njëjtin urdhër, gjyqtari parashikon zbatimin e masës së arrestit në burg nëse i pandehuri refuzon të japë pëlqimin për përdorimin e mjeteve dhe instrumenteve të lartpërmendura."

Një tjetër dispozitë e rëndësishme që duhet të merret parasysh për pasojat e saj është neni 57 i lartpërmendur i Kodit Penal të Shqipërisë, sipas të cilës një (1) ditë paraburgim është baras me një ditë e gjysmë (1.5) të dënimit përfundimtar me burg. Të pandehurit që janë të bindur se do të dënohen në fazën përfundimtare të procesit mund të mos kenë interes për një masë alternative, sepse arresti në burg mund t'u garantojë atyre një "zbritje" më të madhe në dënimin përfundimtar. Ky mund të jetë gjithashtu një faktor që çon në ulje të përdorimit të masave alternative jo me burgim.

Rekomandime

- **Përmirësimi i përdorimit të alternativave ndaj paraburgimit** - të sigurohet që gjyqtarët të vlerësojnë sistematikisht dhe të zbatojnë masa më pak kufizuese përpara se të urdhërojnë paraburgimin, në përputhje me parimin e paraburgimit si fundit.
- **Zgjerimi i objektit të regjimit të garancisë pasurore** - të zgjerohet zbatueshmëria e garancisë pasurore përtej rrezikut të largimit, duke e lejuar të shërbejë si një alternativë ndaj paraburgimit në rastet që përfshijnë rrezikun e përsëritjes së veprës penale ose pengimin e drejtësisë.
- **Mundësimi i garancisë pasurore në fazën fillestare të paraburgimit** - të ndryshohet KPP për të siguruar që gjykatat të vlerësojnë mundësinë e garancisë pasurore **përpara** se të urdhërojnë paraburgimin ose arrestin në shtëpi, në përputhje me Nenin 5(3) të Konventës dhe Rregullat e Tokios të Kombeve të Bashkuara.
- **Krijimi i një sistemi monitorimi elektronik efektiv dhe funksional**, duke ndjekur standardet e përcaktuara në Rekomandimin CM/Rec(2014)4 e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi monitorimin elektronik (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shkurt 2014, në takimin e 1192nd të të Zëvendësministrave).
- **Zbatimi i plotë i Ligjit Nr. 10 494, i datës 22/12/2011**, mbi monitorimin elektronik të personave lëvizja e të cilëve është e kufizuar me vendim gjykate, duke përdorur mjetet e nevojshme teknike dhe duke përshtatur Nenin 237, § 2 të KPP-së.



- **Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës** - të shtohen burimet, trajnimi dhe të forcohet autoriteti i organeve mbikëqyrëse përgjegjëse për monitorimin e pajtueshmërisë me masat alternative.
- **Prezantimi i ndalimit të kontaktit** - të ndryshohet Neni 232 i KPP-së për të përfshirë "ndalim të kontaktit me persona të caktuar".
- **Ndryshimi i nenit 57 të Kodit Penal**, duke e barazuar uljen e dënimit përfundimtar me ditët e kaluara në paraburgim, duke hequr shtesën që është aktualisht në fuqi.

3.6 Konsiderata Specifike për Personat në Situatë Vulnerabël

Neni 230, paragrafi 2 ofron mbrojtje të zgjeruar për gratë shtatzëna, personat e moshuar (mbi 70 vjeç), ata me probleme të rënda shëndetësore dhe personat e varur nga droga/alkooli që i nënshtrohen trajtimit, gjë që është në përputhje me kërkesat minimale të Konventës.

Kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 (shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim) janë më të rrepta se baza e Konventës dhe mbështesin karakterin e masës së fundit të paraburgimit, e cila është në përputhje me Rregullat e Bangkokut/Mandelës të OKB-së dhe me këndvështrimin e Gjykatës mbi cenueshmërinë.

Sa i përket të miturve, megjithëse neni 229 paragrafi 3 përmend që gjykata duhet të marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete, dispozita e nenit 230, paragrafi 4 (Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale) duket se nuk i plotëson standardet e Gjykatës - paraburgimi i të miturve duhet të përdoret vetëm si masë e fundit; duhet të jetë sa më i shkurtër të jetë e mundur dhe, kur paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm, të miturit duhet të mbahen veçmas të rriturve³⁵.

KPP duhet të përshtatet me kërkesat e përcaktuara në Direktivën (BE) 2016/800 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 11 majit 2016, mbi garancitë procedurale për të miturit që janë të dyshuar ose të akuzuar në procese penale: kufizimi i rasteve kur paraburgimi mund të jetë i zbatueshëm për të miturit, ndihma e detyrueshme kur vendoset ndalimi/paraburgimi; përshtatshmëria e avokatit; shpjegime të përshtatura.

Lidhur me gratë, gratë shtatzëna duhet të lejohen të lindin në spital jashtë qendrave të paraburgimit dhe të mbajnë fëmijët e mitur me vete (gjithmonë kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës).

Shtetasit e huaj, përveç të drejtave të përcaktuara tashmë në nenet 34/b, § 1, c) dhe 123 (e drejta për të kontaktuar shërbimet diplomatike/konsullore dhe e drejta për shërbime profesionale të përkthimit), duhet të kenë të drejtën e informimit në lidhje me ndihmën juridike dhe me mundësitë e transferimit të dënimit.

Një çështje tjetër e rëndësishme lidhet me masat kundër radikalizmit. Duhet të krijohet një sistem vlerësimi fillestar i rrezikut për të dyshuarit terroristë/ekstremistë, së bashku me vlerësime të rregullta të riskut gjatë paraburgimit. Stafi duhet të trajnohet për të dalluar

³⁵ Nart kundër Turqisë, nr. 20817/04, 6 maj 2008, § 31; Güveç kundër Turqisë, nr. 70337/01, 20 janar 2009, § 109.



shenjat e radikalizimit dhe duhet të zbatohen programe për rehabilitimin dhe de-radikalizimin.

Rekomandime

- Përcaktimi që **paraburgimi i të miturve** duhet të përdoret vetëm si masë e fundit; duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur dhe, kur paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm, të miturit duhet të mbahen veçmas të rriturve.
- **Përcaktimi i garancive procedurale për të miturit:** kufizimi i rasteve kur paraburgimi mund të jetë i zbatueshëm për të miturit, ndihma e detyrueshme kur urdhërohet ndalimi/paraburgimi; përshtatshmëria e avokatit; shpjegime të përshtatura.
- Për **gratë**, lejimi i grave shtatzëna të lindin në spital jashtë ambienteve të paraburgimit dhe të mbajnë fëmijët e mitur me vete (gjithmonë kur është në përputhje me interesat më të mira të fëmijës).
- **Përcaktimi që shtetasit e huaj** të kenë të drejtën e informimit në lidhje me ndihmën ligjore dhe në lidhje me mundësitë e transferimit të dënimit.
- **Vendosja e masave kundër radikalizimit;** një sistem vlerësimi fillestar i rrezikut për të dyshuarit terroristë/ekstremistë, së bashku me vlerësime të rregullta të rrezikut gjatë paraburgimit; trajnimi i stafit për të njohur shenjat e radikalizimit; zbatimi i programeve të rehabilitimit dhe de-radikalizimit.

3.7 Ankimimi dhe mjetet juridike

Neni 5, paragrafi 5 i Konventës parashikon se çdo person, që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, ka të drejtën e zbatueshme të dëmshpërblimit.

Neni 268 i KPP-së përfshin të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë, përkatësisht:

- Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.
- në rastet e ndalimit të paligjshëm, pavarësisht nga fajësia e personit.
- në rastet e personave, çështjet e të cilëve janë pushuar nga gjykata ose prokurori.

Kërkesa për kompensim duhet të paraqitet brenda tre vjetësh.

Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë.

Përfshirja e arrestit në shtëpi duhet të konsiderohet si një aspekt pozitiv.

Duke marrë parasysh këto rregulla, legjislacioni penal shqiptar garanton parimin e së drejtës për kompensim për ata që i nënshtrohen paraburgim të padrejtë, në përputhje me nenin 5, paragrafi 5 të Konventës.

Megjithatë, sa i përket zbatimit konkret të së drejtës për kompensim, i bëhet referencë një 'ligji të veçantë'. Ligji nr. 9381 i datës 28.04.2005 "*Për kompensimin e burgimit të padrejtë*" është akti



operativ mbi të drejtën për kompensim. Gjykatat vlerësojnë të ardhurat dhe rrethanat, por ligji vendos kufij, përkatësisht deri në 3,000 lekë/ditë për paraburgimin, deri në 2,000 lekë/ditë për burgimin. Arresti në shtëpi kufizohet në jo më shumë se gjysmën e normës së burgimit ($\leq 1,000$ lekë/ditë), gjë që është shumë e kufizuar, veçanërisht për periudha të gjata në arrest shtëpie.

Është e rëndësishme që ky 'ligj i veçantë' të jetë plotësisht i zbatueshëm dhe të ofrojë një mekanizëm konkret për llogaritjen e të drejtës për kompensim, duke përfshirë dëmin jo pasuror.

Një vërejtje e fundit ka të bëjë me pagesën përfundimtare të kompensimit. Kjo duhet të garantohet dhe të mbrohet me afate kohore.

Rekomandime

- **Rishikimi i kufizimeve dhe përjashtimeve** - të rishikohen përjashtimet kufizuese, të tilla si mohimi i kompensimit kur vendimi i gabuar është "shkaktuar tërësisht ose pjesërisht" nga personi.
- **Rishikimi i ligjit të posaçëm për kufijtë e kompensimit** - të përditësohet Ligji nr 9381/2005 për të siguruar që nivelet e kompensimit të jenë realiste dhe proporcionale me dëmin real. Kompensimi duhet të pasqyrojë në mënyrë adekuate edhe **dëmin pasuror edhe dëmin jo pasuror**.
- **Përfshirja shprehimisht e arrestit në shtëpi njësoj si arresti në burg.**
- **Garantimi i zbatimit efektiv të vendimeve të kompensimit** - të prezantohen garanci që sigurojnë që vendimet e kompensimit të **paguhen menjëherë**, me afate ligjore dhe mekanizma për të parandaluar vonesat administrative.
- **Sigurimi i transparencës dhe aksesueshmërisë** - të jepen rregulla të qarta procedurale dhe udhëzime të aksesueshme për kërkuesit mbi mënyrën se si të paraqesin kërkesat për kompensim. Ndihma ligjore duhet të jetë në dispozicion për të siguruar që personat në situatë vulnerabël të mund të kërkojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive.



4 ÇËSHITJE NDËRSEKTORIALE

4.1 Mbledhja e të dhënave

Ekspertëve iu dhanë dy grupe të dhënash statistikore.

I pari ishte një dokument i përgjithshëm i titulluar *Informacion mbi Paraburgimin* i korrikut 2025.

Ajo që bie në sy në këto shifra, pa dyshim shumë të përgjithshme, është raporti veçanërisht i lartë i personave në paraburgim krahasuar me numrin e banorëve në Shqipëri. Duhet theksuar se me një shkallë arrestimi prej 2,623 personash në një popullsi prej 2,771,508 banorësh, raporti është 94.6 persona në paraburgim për 100,000 banorë. Ky raport është tepër i lartë krahasuar me Shtetet Anëtare të BE-së. Në Belgjikë, ky raport aktualisht mund të vlerësohet në rreth 10 persona për 100,000 banorë. Edhe pse këshillohet të tregohet veçanërisht kujdes në nxjerrjen e përfundimeve në bazë të statistikave shumë rudimentare, kjo duket se është një shifër tepër e lartë.

Shifrat e marra tregojnë gjithashtu një disbalancë të madhe gjinore: burrat përbëjnë 98.2% të të gjithë të paraburgosurve (2,578 nga 2,623). Kjo pabarazi është edhe më e theksuar se sa pritej. Vetëm 9 të mitur mbahen në paraburgim, dhe përfaqësojnë 0.3% të popullsisë totale të të paraburgosurve. Kjo është një gjetje pozitive, duke supozuar që alternativat brenda sistemit të drejtësisë për të mitur funksionojnë në mënyrë efektive.

Statistikat gjithashtu mundësojnë disa përfundime në lidhje me llojet e krimeve. Veprat penale që lidhen me narkotikët përbëjnë kategorinë më të madhe (887 raste, afërsisht 34% e totalit), duke treguar ose një prevalencë të lartë të krimit të lidhur me drogën ose politika të rrepta për drogën që rezultojnë në paraburgim. Rastet e vrasjeve (231) gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme, duke reflektuar përdorimin e paraburgimit në rastet e krimeve të rënda të dhunshme ku vihet në rrezik siguria publike. Rastet e vjedhjes (392), kategoria e dytë më e madhe, ngrenë shqetësime për proporcionalitetin - përveçse nëse ato janë të lidhura me krimin e organizuar ose rrjetet kriminale.

Një nga çështjet kryesore në Shqipëri është kohëzgjatja e paraburgimit. Mesatarja prej 253 ditësh (8.4 muaj) është e konsiderueshme dhe ka të ngjarë të tejkalojë standardet ndërkombëtare. Për krahasim, në Belgjikë, paraburgimi që zgjat më shumë se tre muaj i nënshtrohet një shqyrtimi të kujdesshëm. Vetëm në kushte specifike - siç janë përsëritja e veprave penale, dënimet e mëparshme, shqetësimet serioze për shëndetin mendor, përfshirja në krimin e organizuar ose kërcënimet e qarta ndaj sigurisë publike - paraburgimi mund të zgjatet përtej kësaj periudhe. Në gjashtë muaj, paraburgimi bëhet një prag kritik dhe zgjatja e mëtejshme justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, siç janë rastet e vrasjeve ose krimi i organizuar ndërkufitar veçanërisht i rëndë.

Situata është edhe më e çuditshme në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), ku periudha mesatare e paraburgimit arrin 616 ditë (mbi 20 muaj). Paraburgimi për periudhë kaq të gjatë mund të pasqyrojë kompleksitetin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, por gjithashtu tregon vonesa të tepruara. Edhe pse 1611 persona u liruan brenda një periudhe shtatë-mujore, kohëzgjatja mesatare e paraburgimit tregon mungesë efikasiteti në sistem.



Për rrjedhojë, hendeku ndërmjet kohëzgjatjes së shqyrtimit në gjykatat e zakonshme dhe të posaçme nuk lejon krahasime domethënëse, sepse llojet e çështjeve që trajtojnë këto institucione janë thelbësisht të ndryshme.

Statistikat e dyta të marra ishin të Dhënat Statistikore për të Paraburgosurit - 2024 dhe Janar-Qershor 2025. Përfshihen dy grupe të dhënash, përkatësisht "Çështjet me të paraburgosur - Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (duke përjashtuar Tiranën)" dhe "Arresti në Burg - Masat: Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm". Dallimi ndërmjet grupeve të të dhënave është i paqartë dhe grupet e të dhënave janë të paqarta. Prandaj, është e pamundur të arrish në përfundime të bazuara, sipas këtij informacioni. Nëse krahasoni dy grupe të dhënash dhe i dyti përfshin çështjet e Tiranës, duket se shumica e paraburgimeve janë të lidhura me Tiranën. Kjo sugjeron një sistem tepër të centralizuar që mund të shkaktojë vonesa.

Një vëzhgim tjetër, i cili, duke pasur parasysh pikat e lartpërmendura, mund të bëhet me shumë kujdes, është që shkalla e ankimit në gjykatat e posaçme është më e lartë se në gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm. Shkalla më e lartë e ankimit në gjykatat e posaçme sugjeron ose ndjekje penale më të kontestuara ose të pandehur me burime më të mëdha për të kundërshtuar vendimet e paraburgimit në çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sidoqoftë, me 37% deri në 44% të çështjeve që shkojnë në gjykatat e apelit, sistemi është i mbingarkuar. Kjo e fundit pa dyshim ka një ndikim në funksionimin e sistemit dhe në zgjatjen e paraburgimit, siç është vëzhguar.

Gjykata e Posaçme trajton më pak çështje, por kompleksiteti (2,61 të paraburgosur për çështje) dhe afatet më të gjata të shqyrtimit tregojnë nevojën për burime të specializuara.

Ai që në fakt është vëzhgimi më i qartë dhe më i rëndësishëm është që **nevojitet urgjentisht një monitorim i qartë/i detajuar**. Me shkallën e paraburgimit në Shqipëri prej 94.6 personash për 100,000 banorë që është rreth katër ose pesë herë më e lartë se mesatarja e BE-së, monitorimi i rreptë është thelbësor për të identifikuar fushat specifike që kërkojnë reformë. Përjashtimi i të dhënave të gjykatës së Tiranës — e cila duket se trajton afërsisht 56% të të gjitha çështjeve të juridiksionit të përgjithshëm — krijon një pengesë masive në statistikën kombëtare. Ndryshimi në periudhat e mbledhjes së të dhënave, kategorizimet e gjykatave dhe kornizat përkufizuese e bëjnë analizën e tendencës pothuajse të pamundur dhe pengojnë vlerësimin e saktë të performancës së sistemit. Me periudha mesatare paraburgimi nga 253 ditë (e përgjithshme) deri në 616 ditë (gjykatat e posaçme), monitorimi sistematik është thelbësor për të identifikuar çështjet që i afrohen kufijve të rrezikshëm të paraburgimit dhe për të parandaluar shkeljet e standardeve të afateve të arsyeshme. Monitorimi i përmirësuar nuk është thjesht një përmirësim administrativ, por një kërkesë themelore. Nevojitet urgjentisht një transparencë më e madhe.

Për të trajtuar numrin e lartë të paraburgimeve, **autoritetet shqiptare duhet të kryejnë një studim të plotë dhe gjithëpërfshirës, duke mbuluar jo vetëm të dhënat statistikore dhe empirike, por edhe çështjet tematike**. Duhet të krijohet një ekip i posaçëm për të kryer një studim të tillë, sipas modelit të propozuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian në *"Instrumenti i Vlerësimit të Paraburgimit"* të vitit 2017³⁶. Ky do të ishte një mjet thelbësor për të nxitur ndryshimet në kulturën gjyqësore që do të referohen më poshtë.

³⁶ E gjeni në <https://rm.coe.int/pre-trial-detention-assessment-tool/168075ae06> (aksesuar më 18/09/2025).



Rekomandime

- **Kryerja e një studimi gjithëpërfshirës mbi paraburgimin**, duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe BE në dokumentin "*Instrumenti i Vlerësimit të Paraburgimit*".

4.2 Nevoja për një ndryshim në kulturën gjyqësore - një qasje globale

Analiza e kryer ka zbuluar se legjislacioni shqiptar është në thelb në përputhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me paraburgimin. Rekomandimet e formuluar më sipër, sipas ekspertëve, do ta përmirësonin regjimin, por nuk ndikojnë në parimet kryesore të garancive ekzistuese.

Megjithatë, Shqipëria tregon një nga raportet më të larta të të paraburgosurve në Evropë - sipas raportit SPACE të vitit 2024, Shqipëria ka një shkallë prej 58% të paraburgimit, më e larta mes vendeve të studiuara.³⁷ Duke pasur parasysh shifrat e vendeve fqinje, kjo nuk mund të shpjegohet me ndonjë lloj trendi rajonal - Bullgaria (5%), Maqedonia e Veriut (12%) dhe Rumania (13%) janë ndër vendet me raportet më të ulëta të të paraburgosurve.³⁸

Nga analiza e kryer në këtë dokument udhëzues rezulton që ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet "ligjit në letër" dhe "ligjit në veprim": megjithëse regjimi ligjor në Shqipëri ndjek standardet kryesore ndërkombëtare, zbatimi i tij nuk parandalon përdorimin dukshëm të tepruar të paraburgimit.

Hendeku ndërmjet legjislacionit dhe praktikës në lidhje me paraburgimin është një tipar i përbashkët në disa vende, nga tradita të ndryshme gjyqësore. Tendenca për ta trajtuar problemin ekskluzivisht përmes ndryshimeve legjislative ka rezultuar e pasuksesshme në disa raste.

Merrni shembullin e Anglisë dhe Uellsit. Një studim i vitit 2016³⁹ identifikoi disa mangësi në vendimet e paraburgimit. Edhe pse ligji i kishte të gjitha garancitë dhe ndiqte standardet ndërkombëtare, praktika e gjykatave ndryshonte nga ligji:

- Gjykatat i kushtonin pak kohë seancave për paraburgimin, pjesërisht për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve dhe mungesës së burimeve;
- Informacioni përkatës që u jepej avokatëve mbrojtës dhe madje edhe gjykatave shpesh ishte i kufizuar dhe varej shumë nga përmbledhjet e çështjeve të bëra nga policia, duke rezultuar në marrjen e vendimeve pa njohuri të plota të fakteve përkatëse;
- Vendimet shpesh nuk përmendnin konkretisht faktet e çështjes dhe rrethanat e të pandehurit, për shkak të kompleksitetit në rritje të ligjit për paraburgimin, duke bërë që shumë të pandehur të mos e kuptonin arsyen e mbajtjes në paraburgim dhe shumë avokatë mbrojtës të besonin se gjykatat favorizonin prokurorinë;

³⁷ Aebi, M. F. & Cocco, E. (2025). [SPACE I - 2024 – Council of Europe Annual Penal Statistics: Prison populations](https://wp.unil.ch). Këshilli i Evropës, e gjeni në <https://wp.unil.ch> (aksesuar më: 18/09/2025). Shihni edhe [Prisons and Prisoners in Europe 2024: Key Findings of the SPACE I survey](https://wp.unil.ch), e gjeni në <https://wp.unil.ch>, (aksesuar më: 18/09/2025).

³⁸ Po aty.

³⁹ Cape, Ed; Smith, Tom, [The practice of pre-trial detention in England and Wales: Research report](https://uwe-repository.worktribe.com), Bristol: Universiteti i West of England, 2016, e gjeni në <https://uwe-repository.worktribe.com>, (aksesuar më: 18/09/2025).



- Mungonte informacioni mbi alternativat ndaj paraburgimit dhe mungonte besimi se kushtet e lidhura me masat jo me burgim do të zbatoheshin në mënyrë përshtatshme, duke çuar në rritje të vendimeve për paraburgim;
- Në praktikë ndodhte një zhvendosje e barrës së provës në rishikimin e vendimeve të paraburgimit, duke vendosur mbi të pandehurit barrën e të provuarit para një gjykate të radhës që ata duhej të liroheshin.

Pas këtij studimi dhe rekomandimeve të tij, në vitin 2017 u bënë ndryshime në Rregullat e Procedurës Penale, të destinuara për të siguruar "kohë të mjaftueshme" për vendimmarrjen mbi vendimet e paraburgimit, njohjen e mbrojtjes me të gjitha provat përkatëse dhe plotësinë e arsytimit të vendimeve⁴⁰.

Megjithatë, kjo reformë legjislative rezultoi e pamjaftueshme. Një studim i kryer në vitin 2020 tregoi se ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale nuk e ndryshuan punën e përditshme të gjykatave, përkatësisht në lidhje me kohën e dedikuar për seancat e caktimit të masës së sigurimit arrest në burg dhe arsytimin e vendimeve. Perceptimi i arsyeve pas kësaj mungese të zbatimit të rregullave të reja ndryshonte: ndërsa magjistratët vlerësonin se rregullat e reja vetëm konfirmonin atë që ata kishin bërë më parë (pra ishin të panevojshme), avokatët vlerësonin se gjykatat thjesht i injoronin ndryshimet dhe kështu problemet mbetën të pazgjidhura⁴¹.

Hulumtimet krahasuese kanë treguar gjithashtu se pavarësisht dallimeve mes sistemeve ligjore, problemet që ndikojnë në vendimet e paraburgimit janë të zakonshme dhe të vështira për t'u trajtuar vetëm përmes reformës legjislative. Edhe në vendet me sisteme të ndryshme ligjore dhe gjyqësore, çështjet në lidhje me arsytimin e vendimeve, njohjen me provat, tendencën për të favorizuar ndjekjen penale dhe paraburgimin ose mosmarrjen parasysh të alternativave ndaj paraburgimit janë tipar i vazhdueshëm⁴².

Më shumë se kuadri ligjor, është kultura gjyqësore/ligjore ajo që ka një ndikim vendimtar në mënyrën se si zbatohet paraburgimi. Një studim për Irlandën dhe arsyet e shkallës së ulët të paraburgimit⁴³ në Irlandë kanë arritur në përfundimin se kjo është rezultat jo vetëm i një kuadri ligjor të fortë dhe të orientuar drejt lirisë, por edhe i të kuptuarit njësoj nga profesionistët (gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë) të rolit dhe qëllimit të paraburgimit. Siç përfundon ky studim, *"përpyekjet për të zvogëluar përdorimin e paraburgimit duhet të synojnë jo vetëm legjislacionin dhe normat ligjore, por edhe trajnimin gjyqësor dhe ligjor dhe elementët më të paprekshëm të mënyrës se si profesionistët e ligjit e shohin rolin e tyre dhe objektivat e vendimmarrjes për paraburgimin"*⁴⁴.

Ky realitet tregon se nëse Shqipëria synon të trajtojë raportin e lartë të paraburgimit, ajo duhet të përqendrohet jo vetëm në reformën ligjore, por t'i kushtojë më shumë vëmendje

⁴⁰ [The Criminal Procedure \(Amendment\) Rules 2017](#), e gjeni në www.legislation.gov.uk (aksesuar më: 18/09/2025).

⁴¹ Smith, T., [The Practice of Pre-trial Detention in England & Wales - Changing Law and Changing Culture](#), *European Journal on Criminal Policy and Research*, 28, 435–449 (2022). E gjeni në www.doi.org (aksesuar më: 18/09/2025).

⁴² Shihni analizën e sistemit holandez dhe anglez/Uelsh të bërë nga Dhami, M.K.; van den Brink, Y.N., [A Multi-disciplinary and Comparative Approach to Evaluating Pre-trial Detention Decisions: Towards Evidence-Based Reform](#), *European Journal on Criminal Policy and Research*, 28, 381–395 (2022). E gjeni në www.doi.org (aksesuar më: 18/09/2025).

⁴³ Rogan, M., [Examining the Role of Legal Culture as a Protective Factor Against High Rates of Pre-trial Detention: the Case of Ireland](#), *European Journal on Criminal Policy and Research*, 28, 425–433 (2022). E gjeni në www.doi.org (aksesuar më: 18/09/2025).

⁴⁴ Po aty.

kulturës gjyqësore dhe ligjore. Nëse ndryshimet bëhen vetëm në nivelin e legjislacionit, ato ka shumë të ngjarë të mos kenë sukses në uljen e nivelit të lartë të përdorimit të paraburgimit.

Një qasje globale është e nevojshme për të adresuar çështjen: **një strategji institucionale duhet të miratohet bashkërisht nga Ministria e Drejtësisë dhe organet e qeverisjes gjyqësore, me mision, vizion, qëllime dhe objektiva strategjike të qartë (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë).**

Planifikimi strategjik në sektorin publik njihet gjithnjë e më shumë si një mjet thelbësor menaxhimi që shtrihet përtej përkufizimit të thjeshtë të shpërndarjes efektive të burimeve. John M. Bryson e përkufizon atë si *"një përpjekje të disiplinuar për të prodhuar vendime dhe veprime themelore që formësojnë dhe orientojnë se çfarë është një organizatë, çfarë bën dhe pse e bën"*⁴⁵. Pra rëndësia e zhvillimit të një plani strategjik është shumëdimensionale dhe ndikon në aspekte të shumta të funksionimit të organizatës. Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP), duke iu referuar veçanërisht sektorit të drejtësisë, e përshkruan një plan strategjik si një plan që, mes qëllimeve të tjera:

- ofron një mundësi për të reflektuar të kaluarën dhe për të menduar nga e para për të përballuar sfidat e së ardhmes;
- përcakton një ndjenjë qëllimi dhe kështu përcakton arsyetimin për ekzistencën edhe në të ardhmen;
- përcakton një largim nga ad-hoc-izmi dhe kalon në një mënyrë më të qëllimshme dhe të orientuar drejt të nxënit;
- krijon konsistencë të të gjitha punëve organizative drejt objektivave të deklaruara;
- siguron përdorim efikas të burimeve për më shumë efektivitet, pasi vë në pikëpyetje praktikat ekzistuese duke pasur parasysh nevojat;
- krijon bazën për matjen, rishikimin dhe ndryshimin e performancës;
- krijon transparencë mes të gjithë anëtarëve të stafit dhe ndaj elementëve të jashtëm".⁴⁶

Një strategji institucionale nuk është thjesht një listë masash të izoluara - ajo fillon me një analizë të situatës aktuale, e ndjekur nga një përkufizim i qartë i objektivave dhe një planifikim i hapave që duhen ndërmarrë për të arritur këto objektiva. Kjo qasje siguron që të gjitha aktivitetet të jenë koherente dhe të përfuara me misionin.

Prandaj, një strategji institucionale duhet t'u përgjigjet tre pyetjeve themelore:

- ku ndodhemi aktualisht?
- ku synojmë të shkojmë?
- çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të arritur këtë qëllim?

Secila prej këtyre pyetjeve korrespondon me tre (3) pjesë nga të cilat duhet të përbëhet strategjia institucionale:

⁴⁵*Strategic Planning for Public and Nonprofit Organizations: A Guide to Strengthening and Sustaining Organizational Achievement*, Botimi i 5të 5th, Wiley, Dhjetor 2017.

⁴⁶*Strategic Planning of the Justice Sector Institutions - A Handbook for Planner*, UNDP / Verulam Associates Bangladesh, Ltd, 2014, e gjeni në www.undp.org (aksesuar më: 17/09/2025).



- analiza strategjike (ku ndodhemi aktualisht);
- kuadri strategjik (ku synojmë të shkojmë);
- strategjitë (çfarë masash duhet të ndërmerren për të arritur këtë qëllim).

Në këtë kuadër, ekspertët besojnë se autoritetet qeveritare dhe të qeverisjes gjyqësore në Shqipëri duhet të përcaktojnë një strategji të përbashkët institucionale.

Bazuar në analizën e kryer tashmë, e cila tregon se Shqipëria ka raportin më të lartë të paraburgimit në zonën e Këshillit të Evropës, **qëllimi afatgjatë duhet të jetë ulja e këtij raporti në nivele të pajtueshme me standardet e Këshillit të Evropës.**

Zhvillimi i një strategjie institucionale përfshin përkufizimin e vizionit, misionit dhe vlerave, nga të cilat rrjedhin objektiva të qarta strategjike. Në këtë drejtim, sipas ekspertëve, këto mund të jenë vizioni, misioni dhe vlerat që duhen përcaktuar:

- **vizioni:** në planin afatgjatë të arrihet një raport i paraburgimit në Shqipëri që është brenda niveleve më të ulëta mes shteteve anëtare të Këshillit të Evropës;
- **misioni:**
 - o Promovimi i respektimit të të drejtave themelore, ligjit, Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;
 - o Sigurimi i ofrimit të një shërbimi gjyqësor cilësor, efektiv dhe të drejtë;
 - o Krijimi i besimit në sistemin gjyqësor mes qytetarëve dhe profesionistëve të ligjit.
- **vlerat:**
 - o Pavarësia
 - o Integriteti
 - o Efikasiteti
 - o Cilësia
 - o Transparenca dhe Llogaridhënia

Bazuar në këtë kuadër strategjik, mund të përcaktohen këto **Strategji ose Objektiva Strategjike kryesore:**

1. Përshtatja e regjimit ligjor të paraburgimit për të favorizuar masat jo me burgim.
2. Krijimi i besimit mes aktorëve gjyqësorë në efikasitetin e masave jo me burgim.
3. Krijimi i besimit publik në shoqëri në efikasitetin e sistemit dhe në masat jo me burgim.

Sipas secilës prej këtyre objektivave strategjike, duhet të përcaktohen masa konkrete, të ndara sipas periudhave afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, me përcaktimin e organeve/individëve përgjegjës për zbatimin e tyre.

Objektivi strategjik 1. duhet të përfshijë:



- Rekomandimet e bëra më sipër në lidhje me aspektet individuale të regjimit, duke përfshirë parimin se liria është rregull dhe paraburgimi është përjashtim dhe, për këtë qëllim, i takon prokurorisë të mbajë barrën e provës për nevojën e asaj mase të jashtëzakonshme dhe gjyqtarit të shpjegojë arsyet pse masat jo me burgim nuk janë të mjaftueshme ose të përshtatshme;
- Krijimi i një sistemi efektiv dhe funksional i mbikëqyrjes elektronike, si alternativë ndaj paraburgimit.

Objektivi strategjik 2. duhet të përfshijë:

- Trajnim intensiv të vazhdueshëm për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbi standardet ndërkombëtare mbi paraburgimin, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës (me Programin HELP - *Edukimi për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët e Ligjit*) dhe Bashkimi Evropian (*Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor* mund të jetë një partner i vlefshëm);
- Sapo të jetë krijuar sistemi i mbikëqyrjes elektronike, të zhvillohen aktivitete ndërgjegjësimi në vend për gjyqtarët dhe prokurorët, për t'u treguar atyre se sistemi funksionon dhe është i besueshëm, duke nxitur kështu përdorimin e tij nga ana e tyre;
- Krijimi i një komiteti të përhershëm për të monitoruar paraburgimin, të përbërë nga anëtarë të gjyqësorit, bota akademike dhe qeveria/parlamenti, për të analizuar dhe për t'iu përgjigjur në kohën e duhur çdo ndryshimi që mund të jetë i nevojshëm.

Objektivi strategjik 3. duhet të përfshijë hartimin e një strategjie për median që synon:

- rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë që paraburgimi nuk duhet të shihet si një 'ndëshkim i parakohshëm' dhe që Shqipëria ka një nga rekordet më të këqija në Evropë në këtë drejtim, duke gjeneruar kështu ndërgjegjësimin e publikut për nevojën për ndryshim;
- dhënien e shembujve të vendeve ku është zbatuar dhe funksionon mbikëqyrja elektronike duke rritur kështu besimin e publikut në këto sisteme dhe rrjedhimisht duke zvogëluar presionin e publikut mbi aktorët e sistemit gjyqësor për të zbatuar masën e arrestit në burg;
- dhënien në vazhdimësi të informacioneve të besueshme dhe të përditësuara për publikun mbi numrin e proceseve penale ku janë caktuar masat jo me burgim dhe shkallën e suksesit të tyre.

Zhvillimi i kësaj strategjie institucionale duhet t'i besohet një grupi pune të ngritur nga Ministria e Drejtësisë/Parlamenti, me një përbërje të larmishme (politikanë, akademikë dhe anëtarë të gjyqësorit) dhe me një mandat të kufizuar në kohë.

Siç është përmendur tashmë, secila prej masave duhet të shoqërohet me **përcaktimin e personit/grupit të personave përgjegjës për zbatimin e saj dhe afatet kohore** përkatëse, si dhe **treguesit e vlerësimit** që lejojnë verifikimin e nivelit të zbatimit të secilës mase individuale.

Monitorimi i ekzekutimit të planit është gjithashtu thelbësor - raportet periodike duhet të bëhen nga grupi i punës dhe t'i paraqiten Parlamentit mbi nivelin e ekzekutimit të planit strategjik, arsyet e moszbatimit të disa masave dhe ndryshimet/përshtatjet e nevojshme.



Ekspertët besojnë se vetëm përmes kësaj qasjeje të koordinuar dhe globale dhe jo duke u mbështetur ekskluzivisht në ndryshimet ligjore - Shqipëria do të jetë në gjendje të trajtojë problemin e vazhdueshëm të raportit të lartë të paraburgimit.

Rekomandime

- **Përcaktimi i një strategjie institucionale që synon të ulë raportin e paraburgimit** në Shqipëri në nivele të pajtueshme me standardet e Këshillit të Evropës, me përcaktimin e vizionit, misionit dhe vlerave, nga të cilat rrjedhin objektiva të qarta strategjike, së bashku me personat përgjegjës dhe treguesit e vlerësimit.



5 KONKLUZIONE

Tabelë përmbledhëse e rekomandimeve

I. PARABURGIMI: BAZAT LIGJORE DHE GARANCITË	1. Shkaqet dhe vendimi për paraburgim	- Qartësimi i koncepteve të paqarta ligjore - të formulohen përkufizime të qarta ligjore ose udhëzime gjyqësore për terma të paqarta siç janë "shkaqe të një rëndësie të veçantë" ose "rrezikshmëria e veçantë" (Nenet 228–230 të KPP-së). - Përafrimi i terminologjisë me standardet ndërkombëtare dhe Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/6816, duke siguruar parashikueshmëri dhe siguri juridike. - Miratimi i kufijve të qartë të veprave penale për paraburgimin - të vlerësohet ndryshimi i KPP për të futur një kufi minimal dënimi me burgim për të urdhëruar paraburgimin (në këtë DU propozohet një kufi tre-vjeçar, por të paktën një vit, siç rekomandohet në Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/681). - Forcimi i kërkesave të arsytimit gjyqësor - të zbatohet neni 245 i KPP duke kërkuar që gjyqtarët të bëjnë arsyetim individual dhe specifik për rastin kur vendosin paraburgimin. - Prezantimi i mjeteve të strukturuar të vlerësimit të riskut për të mbështetur
--	--	--

		gjqtarët në vlerësimin nëse masat më pak ndërhyrëse mund t'i adresojnë risqet mjaftueshëm. - Gjykatat të dokumentojnë në mënyrë të qartë në vendime pse masa të tilla si garancia pasurore, detyrimi për t'u paraqitur ose monitorimi elektronik do të ishin të pamjaftueshme.
	2. Seanca dhe mbikëqyrja gjyqësore	- Përmirësimi i cilësisë së arsyetimit gjyqësor - të ofrohet trajnim dhe monitorim për të siguruar që vendimet e paraburgimit të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe të individualizuar dhe jo referenca mekanike - arsyetimi duhet të adresojë në mënyrë të qartë arsyen pse alternativat janë të pamjaftueshme dhe pse paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm. - Investimi në forcimin e kapaciteteve gjyqësore - të zhvillohet trajnim i vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët. - Zgjatja e afatit për paraqitjen e ankimit ndaj vendimeve të paraburgimit nga pesë në dhjetë ditë. - Forcimi i kontrollit në apel - të rritet efektiviteti i mekanizmave të apelit duke



		siguruar që gjykatat e apelit të shqyrtojnë me rigorozitet arsyetimin në shkallën e parë. - Qartësimi i objektit të shqyrtimit në apel - të ndryshohet neni 249 i KPP-së për të shprehur në mënyrë të qartë që gjykatat e apelit duhet të shqyrtojnë si elementët faktikë ashtu edhe elementët ligjorë të urdhrit të paraburgimit, duke përfshirë provat në dispozicion, shkaqet e pretenduara (rreziku i largimit, rreziku i përsëritjes së veprës penale, pengimi i drejtësisë), dhe proporcionalitetin e paraburgimit në lidhje me alternativat. - Garantimi i së drejtës për t'u dëgjuar në apel - të kodifikohet që si i dyshuari ashtu edhe avokati i tij duhet të dëgjohen gjatë proceseve në apel. - Prezantimi i fleksibilitetit të kufizuar në afatet kohore - të mbahet afati dhjetë-ditor për shqyrtimin në apel, por të lejohet zgjatja e përcaktuar ngushtësisht me kërkesë të mbrojtjes. - Fuqizimi i gjykatave të apelit për urdhërimin e lirimit të menjëhershëm. - Garantimi i të drejtave të mbrojtjes kur paraqiten shkaqe të reja - nëse gjykatat e apelit mund ta mbështetin vendimin e tyre në shkaqe të tjera nga ato të ngritura para gjykatës që cakton masën, KPP duhet të
--	--	--



		kërkojë që të njoftohet mbrojtja dhe t'i jepet mundësia për të kundërshtuar këto shkaqe të reja.
	3. Kohëzgjatja dhe shqyrtimi periodik i paraburgimit	- Kufizimi i kohëzgjatjes maksimale - të vendosen afate kohore maksimale të rrepta që mund të tejkalohen vetëm në raste vërtet të jashtëzakonshme dhe vetëm kur mbështeten nga justifikime konkrete, të individualizuara dhe të mirë-arsyetuara. - Përmirësimi i standardeve të cilësisë së shqyrtimit - të vendosen kriteret më të forta për thellësinë, pavarësinë dhe arsyetimin e shqyrtimeve për të siguruar që ato të jenë thelbësore dhe jo formale. - Shqyrtimi periodik të përqendrohet në vlerësimin/shqyrtimin nëse paraburgimi është ende i nevojshëm, proporcional dhe i arsyeshëm dhe jo vetëm i bazuar në progresin e hetimit. - Vendosja e një rregulli që përcakton një parim të përgjithshëm se prokurori duhet të kërkojë gjithashtu prova në favor të personit nën hetim dhe të informojë menjëherë gjykatën. - Eliminimi i ndalimit kohor prej 6 muajsh para kundërshtimit të kohëzgjatjes së paraburgimit (i vetmi kufizim duhet të jetë



		ndalimi i përsëritjes së argumenteve që janë paraqitur dhe diskutuar tashmë). - Vendosja që afati kohor të fillojë në të njëjtin moment të masës së mëparshme të sigurimit edhe për fakte të ndryshme të kryera para lëshimit të urdhrit të parë për të cilat ekziston një lidhje sipas nenit 55 të KP-së. - Vendosja e barazimit ndërmjet arrestit në shtëpi dhe arrestit në burg dhe ndryshimi i zbritjes në dënimin përfundimtar, në mënyrë që një ditë paraburgimi/arrest në shtëpi të jetë e barabartë me një ditë në dënimin përfundimtar.
	4. E drejta për avokat dhe garanci të tjera procedurale	- Kodifikimi i garancive për heqjen dorë nga avokati - nëse në sistemin shqiptar ekziston mundësia e heqjes dorë nga avokati, të ndryshohet KPP për të kërkuar që çdo heqje dorë nga e drejta për avokat të jetë e informuar, e qartë dhe vullnetare, të regjistrohet me shkrim (ose audio-video), pasi letra e të drejtave të jetë shpjeguar me gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, dhe të jetë konfirmuar me firmën e të dyshuarit. - Forcimi i rolit të avokatit gjatë marrjes në pyetje - të parashikohet shprehimisht në KPP që prania e avokatit mbrojtës nuk është pasive, por aktive, duke i mundësuar atij/asaj të ndërhyjë në marrjen në pyetje, me qëllim



		mbrojtjen e të drejtave ligjore, sqarimin e pyetjeve ose përgjigjeve dhe kundërshtimin e teknikave të papërshtatshme ose shtrënguese të marrjes në pyetje, dhe gjithashtu në momentin e vendimmarrjes për masën, duke propozuar, kur është rasti, alternativa ndaj paraburgimit, pa penguar efikasitetin e marrjes në pyetje. - Garantimi i njohjes në kohë me materialet e çështjes - të sigurohet që të dyshuarit dhe avokatët e tyre të njihen shpejt me dokumentet dhe provat thelbësore të nevojshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe përmbajtjen e akuzave. - Zbatimi i sistemeve të paanshme të avokatëve të gatshëm - të krijohet sistemi i avokatëve të gatshëm 24/7, i menaxhuar nga dhoma e avokatëve, me kohë përgjigjeje të shpejtë, për të parandaluar ndikimin e policisë në përzgjedhjen e avokatëve dhe për të garantuar ndihmë juridike të menjëhershme dhe të pavarur. - Përmirësimi i ambienteve për ndihmë efektive - të kërkohej hapësirë për konsultim privat në të gjitha komisariatet e policisë për të mbrojtur konfidencialitetin ndërmjet avokatëve dhe të dyshuarve.
--	--	--



		- Detyrimi për regjistrimin audio-video të marrjes në pyetje nga policia - të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i të gjitha marrjeve në pyetje, duke dokumentuar si praninë/pjesëmarrjen efektive të avokatëve ashtu edhe çdo heqje dorë nga të drejtat, për të garantuar drejtësinë procedurale dhe besueshmërinë e provave.
	5. Alternativat ndaj paraburgimit	- Përmirësimi i përdorimit të alternativave ndaj paraburgimit - të sigurohet që gjyqtarët të vlerësojnë sistematikisht dhe të zbatojnë masa më pak kufizuese përpara se të urdhërojnë paraburgimin, në përputhje me parimin e paraburgimit si masë e fundit. - Zgjerimi i objektit të regjimit të garancisë pasurore - të zgjerohet zbatueshmëria e garancisë pasurore përtej rrezikut të largimit, duke e lejuar të shërbejë si një alternativë ndaj paraburgimit në rastet që përfshijnë rrezikun e përsëritjes së veprës penale ose pengimin e drejtësisë. - Mundësimi i garancisë pasurore në fazën fillestare të paraburgimit - të ndryshohet KPP për të siguruar që gjykatat të vlerësojnë mundësinë e garancisë pasurore përpara se të urdhërojnë paraburgimin ose arrestin në shtëpi, në përputhje me Nenin 5(3) të



		Konventës dhe Rregullat e Tokios të Kombeve të Bashkuara. - Krijimi i një sistemi mbikëqyrjeje elektronike efektiv dhe funksional - të zhvillohet dhe të zbatohet një infrastrukturë e besueshme e mbikëqyrjes elektronike për të forcuar efektivitetin e masave jo me burgim, duke ndjekur standardet e përcaktuara në Rekomandimin CM/Rec(2014)4 e Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi monitorimin elektronik (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shkurt 2014, në takimin e 1192-të të Zëvendësministrave). - Zbatimi i plotë i Ligjit Nr. 10 494, datë 22.12.2011, mbi mbikëqyrjen elektronike të personave, lëvizja e të cilëve është e kufizuar me vendim gjykatë, duke përdorur mjetet e nevojshme teknike dhe duke përshtatur Nenin 237, § 2 të KPP-së. - Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës - të shtohen burimet, trajnimi dhe të forcohet autoriteti i organeve mbikëqyrëse përgjegjëse për monitorimin e respektimit të masave alternative. - Prezantimi i ndalimit të kontaktit - të ndryshohet Neni 232 i KPP-së për të përfshirë "ndalim të kontaktit me persona të caktuar".
--	--	--



		- Ndryshimi i nenit 57 të Kodit Penal, duke e barazuar uljen e dënimit përfundimtar me ditët e kaluara në paraburgim, duke hequr shtesën që është aktualisht në fuqi.
	6. Konsiderata Specifike për Personat në Situatë Vulnerabël	- Përcaktimi që paraburgimi i të miturve duhet të përdoret vetëm si masë e fundit; duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur dhe, kur paraburgimi është rreptësisht i nevojshëm, të miturit duhet të mbahen veçmas të rriturve. - Përcaktimi i garancive procedurale për të miturit: kufizimi i rasteve kur paraburgimi mund të jetë i zbatueshëm për të miturit, ndihma e detyrueshme kur vendoset ndalimi/paraburgimi; përshtatshmëria e avokatit; shpjegime të përshtatura. - Për gratë, lejimi i grave shtatzëna të lindin në spital jashtë ambienteve të paraburgimit dhe të mbajnë fëmijët e mitur me vete (gjithmonë kur është në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës). - Përcaktimi që shtetasit e huaj të kenë të drejtën e informimit në lidhje me ndihmën juridike dhe në lidhje me mundësitë e transferimit të dënimit. - Vendosja e masave kundër radikalizimit; një sistem vlerësimi fillestar i rrezikut për të dyshuarit terroristë/ekstremistë, së bashku me



		vlerësime të rregullta të rrezikut gjatë paraburgimit; trajnimi i stafit për të njohur shenjat e radikalizimit; zbatimi i programeve të rehabilitimit dhe de-radikalizmit.
	7. Ankimimi dhe mjetet juridike	- Rishikimi i kufizimeve dhe përjashtimeve - të rishikohen përjashtimet kufizuese, të tilla si mohimi i kompensimit kur vendimi i gabuar është "shkaktuar tërësisht ose pjesërisht" nga personi. - Rishikimi i ligjit të posaçëm për kufijtë e kompensimit - të përditësohet Ligji nr. 9381, datë 28.04.2004 për të siguruar që nivelet e kompensimit të jenë realiste dhe proporcionale me dëmin real. Kompensimi duhet të pasqyrojë në mënyrë adekuate dëmin pasuror dhe dëmin jo pasuror. - Trajtimi në mënyrë të qartë i arrestit në shtëpi me të njëjtat kushte. - Garantimi i zbatimit efektiv të vendimeve të kompensimit - të prezantohen garanci që sigurojnë që vendimet e kompensimit të paguhen menjëherë, me afate ligjore dhe mekanizma për të parandaluar vonesat administrative. - Sigurimi i transparencës dhe aksesueshmërisë - të jepen rregulla të qarta procedurale dhe udhëzime të aksesueshme për kërkuesit mbi mënyrën se si të paraqesin



		kërkesat për kompensim. Ndiurma juridike duhet të jetë në dispozicion për të siguruar që personat në situatë vulnerabël të mund të kërkojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive.
II. ÇËSHTJE NDËRSEKTORIALE	1. Mbledhja e të dhënave	- Kryerja e një studimi gjithëpërfshirës mbi paraburgimin , duke ndjekur udhëzimet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe BE në dokumentin "Instrumenti i Vlerësimit të Paraburgimit" .
	2. Nevoja për një ndryshim në kulturën gjyqësore - një qasje globale	- Përcaktimi i një strategjie institucionale që synon të ulë raportin e paraburgimit në Shqipëri në nivele të pajtueshme me standardet e Këshillit të Evropës, me përcaktimin e vizionit, misionit dhe vlerave, nga të cilat rrjedhin objektiva të qarta strategjike, së bashku me personat përgjegjës dhe treguesit e vlerësimit.

